

Manuali i përdorimit

Q2

Audi Vorsprung durch Technik

Prova e garancisë

Nr. i identifikimit të automjetit	
Tipi, fuqia e motorit, kambio, muaji/viti i prodhimit	
Shkronjat e kodeve të motorit dhe kambios	
Kodi i bojës, Nr. i pajisjes së brendshme	
Nr. i pajisjeve opsionale	

Data e lëvrimit:

Vula e ndërmarrjes Audi që kryen lëvrimin

Parathënie

Keni vendosur të blini një Audi – shumë faleminderit për besimin tuaj.

Me Audi-n tuaj të ri do të përjetoni një automjet me teknologji të avancuar dhe me pajisje të cilësisë më të lartë. Audi ju këshillon që ta lexoni me kujdes këtë manual përdorimi, në mënyrë që të njiheni me automjetin dhe që të mund të përdorni të gjitha funksionet në regjimin e përditshëm të drejtimit.

Informacionet mbi përdorimin plotësohen nëpërmjet udhëzimeve të rëndësishme të funksionimit dhe të kujdesit për sigurinë tuaj, si dhe për ruajtjen e vlerës së automjetit tuaj. Përveç kësaj, Audi ju jep këshilla dhe ndihma të dobishme se si ta përdorni automjetin tuaj në mënyrë efikase dhe duke mbrojtur mjedisin.

Audi ju uron shumë argëtim me automjetin tuaj dhe një udhëtim të mbarë në çdo kohë.

VINI RE

Ndiqni këshillat e rëndësishme të sigurisë për përdorimin e sistemeve të kufizimit të fëmijëve në sediljen e pasagjerit përpara ⇨ *faqja 60*.

81B012790AG

Rreth këtij manuali përdorimi . . . 6

Në mënyrë të shkurtër dhe të qartë . . . 7
Hyrje e shpejtë . . . 7
Informacionet online . . . 7
Pyetjet më të shpeshta . . . 7
Kruskoti . . . 10
Pasqyra e dritave të kontrollit . . . 11

Ekrani dhe përdorimi . . . 16
Kruskoti . . . 16
Pasqyrimi i kruskotit . . . 16
Principi i përdorimit . . . 17
Butonat e komandimit . . . 18
Ndryshimi i pamjes . . . 19
Treguesi i temperaturës së substancës ftohëse . . . 19
Matësi i xhirove . . . 20
Numëruesi i kilometrave . . . 20
Treguesi i temperaturës së jashtme . . . 20
Treguesi i temperaturës së vajit të motorit . . . 21
Treguesi i boost . . . 21
Funksionet e automjetit . . . 21
Butona të tjerë funksioni . . . 24

Nisja dhe udhëtimi . . . 25
Hapja dhe mbyllja . . . 25
Mbyllja qendrore . . . 25
Çelësi . . . 30
Dera e bagazhit . . . 33
Siguresa e fëmijëve . . . 36
Ngritësit elektrikë të xhamave . . . 37
Tavani panoramik . . . 38

Drita dhe shikimi . . . 39
Ndriçimi i jashtëm . . . 39
Ndriçimi i brendshëm . . . 43
Pamja . . . 44
Fshirëset e xhamave . . . 46

Ulja e saktë dhe e sigurt . . . 50
Pozicioni i saktë i uljes së pasagjerëve në automjet . . . 50
Sediljet e përparme . . . 50
Timoni . . . 52
Mbështetëset e kokës . . . 53
Rripat e sigurimit . . . 54
Sistemi i jastëkëve të ajrit . . . 57
Sistemet e kufizimit të fëmijëve . . . 60

Ruajtja dhe gjëra të tjera të dobishme . . . 67
Tavlla e duhanit . . . 67
Ndezësi i cigareve . . . 67
Burimet e rrymës . . . 67
Mbajtësi i pijeve . . . 68
Vendet e ruajtjes dhe sirtarët . . . 68
Bagazhi . . . 68
Mbajtësi i bagazheve mbi çati . . . 72

Ngrohtë dhe ftohtë . . . 73
Kondicioneri . . . 73
Ngrohja/ajrimi stacionar . . . 78

Udhëtimi . . . 82
Ndezja e automjetit . . . 82
Regjimi i udhëtimit . . . 85
Sistemi i lëvizjes së mjetit . . . 90
Sistemi Start-Stop . . . 92
Frenimi . . . 93
Freni elektromekanik i parkimit . . . 95
Hapja e emergjencës e bllokuesit të parkimit . . . 97
Situata të veçanta udhëtimi . . . 99

Dinamika e drejtimit . . . 101
Audi drive select . . . 101
Shasia . . . 102
Sistemi i drejtimit . . . 102
Sistemi i lëvizjes me të gjitha rrotat aktive (quattro) . . . 103
Sistemi elektronik i stabilizimit . . . 103

Përdorimi i rimorkios . . . 106
Udhëtimet me rimorkio . . . 106
Mekanizmi i tërheqjes së rimorkios që mund të hiqet . . . 108

Sistemet mbështetëse . . . 115
Sistemet ndihmëse . . . 115
Të përgjithshme . . . 115
Dallimi i mjedisit përreth . . . 116

Informacione për drejtuesin e mjetit 119
Sistemi i paralajmërimit të shpejtësisë . . . 119
Dallimi i shenjave të qarkullimit i bazuar në kamera 119
Rekomandimi i pushimeve 122
Laptimer 123

Asistenca e drejtuesit të mjetit . 126
Sistemet e rregullimit të shpejtësisë 126
Asistenti i udhëtimit që përshtatet 128
Paralajmërimi i distancës 140
Paralajmërimi i largimit nga korsia 141
Audi pre sense 143
Audi side assist 147
Asistenti i emergjencës 149

Parkimi dhe manovrimi 150
Hyrje 150
Ndihma e parkimit mbrapa 150
Ndihma e parkimit plus 151
Kamera për lëvizjen mbrapa 154
Asistenti i trafikut kryq mbrapa 155
Parkimi i asistuar 157
Asistenti i parkimit 159

Sistemi i informimit dhe argëtimit 162
Multi Media Interface 162
Këshilla mbi sigurinë e trafikut 162
Hyrje 162
MMI butoni i ndezjes/i fikjes me funksion Joystick 162
Ekrani i sistemit të informimit dhe argëtimit 163
Principi i përdorimit MMI 164
MMI touch 165
Butoni i komandimit me funksionin Joystick 168
Drejtshkrimi i germave/shifrave 170
Kërkimi i lirë 172
Menytë dhe simbolet 173

Timoni multifunksional plus 175
Hyrje 175
Radio (Radio) 175
Mediat 175
Telephone (Telefoni) 176
Navigimi 177

Sistemi i komunikimit me zë 181
Të përgjithshme 180
Principi i përdorimit 181
Udhëzime për pamjet e përgjithshme të komandave 182
Komandat 182

Telephone (Telefoni) 191
Hyrje 191
Vënia në punë 191
Përdorimi i Audi phone box 195
Përdorimi i telefonit 196
Preferencat 199
Mesazhe 200
Dëgjimi i kutisë postare 203
Directory (Libri i adresave) 203
Cilësime të tjera 205
Vetëndihma 208

Audi connect (Audi connect) 209
Të përgjithshme 209
Sistemi i informimit dhe argëtimit Audi connect 210
Përdorimi i Wi-Fi hotspot 212
Shërbimet e sistemi i informimit dhe argëtimit Audi connect 213
Audi connect Shërbimet e komandimit të automjetit 215
Settings (Cilësimet) 216
Vetëndihma 218

Thirrja e emergjencës 219
Përmbledhje 219
Thirrja e emergjencës 219
Thirrja online e avarive 220

Navigimi 222
Thirrja e navigimit 222
Futja e destinacionit 222
Asistenca personale e itinerarit 229
Adresa e vendlindjes 230
Preferencat 230
Kontaktet e librit të adresave 231
Itineraret alternative 231
Cilësime të tjera 232

81B012790AG

Ky manual përdorimi përmban informacione të rëndësishme, këshilla për sigurinë dhe këshilla për veprimin me automjetin tuaj.

LEXONI KËTË MANUAL PËRDORIMI DHE RUAJENI ATË!

Lexoni me kujdes këtë manual përdorimi përpara përdorimit të automjetit tuaj. Sigurohuni që ky manual përdorimi si dhe dokumentet që i përkasin atij të gjenden gjithmonë në automjet. Kjo vlen sidomos në rastin kur ju ua huazoni ose ua shitni automjetin të tjerëve.

Përditësimi i manualit të përdorimit: Ju lutemi mbani parasysh se Audi[1)] punon në vazhdimësi në zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha produkteve dhe varianteve të modeleve. Audi rezervon të drejtën që të ndryshojë në çdo kohë formën, pajisjet dhe teknologjinë e automjetit që lëvrohet. Në varësi të automjetit dhe të tregut, ndryshimet mund të bëhen të mundura përmes përditësimit të softuerit. Kështu që është e mundur që të përditësohet edhe manuali i përdorimit. Kjo bëhet në formën e shtojcave të ndryshme. Shtojcat mund të vihen në dispozicionin tuaj si në formë të printuar, ashtu edhe në formë digjitale. Nëse shtojca për ju është e vlefshme në formë digjitale apo të printuar, këtë mund ta mësoni nga udhëzimet përkatëse për këtë qëllim, të cilat jepen në shtojcë.

Veçoritë individuale të automjeteve: Përshkrimi bëhet për pajisjet standarde të serisë, pajisjet sipas shtetit dhe pajisjet e veçanta, të cilat disponohen për të gjithë serinë e modelit. Gjithashtu është e mundur që disa nga pajisjet dhe funksionet të përdoren vetëm në një moment të mëvonshëm ose ato mund të blihen vetëm në tregje të caktuara. Prandaj, pjesë e përshkrimit janë edhe gjëra që nuk ekzistojnë në automjetin tuaj. Figurat mund të mos përputhen me automjetin tuaj dhe duhen kuptuar si paraqitje ilustruese. Për këtë arsye, nuk mund të ngrihet asnjë pretendim nisur nga të dhënat, figurat dhe përshkrimet.

Identifikimi i fushës së vlefshmërisë: Disa kapituj nuk vlejnë për të gjitha automjetet. Në këtë rast, në fillim të kapitullit është deklaruar fusha e vlefshmërisë, p.sh. „Vlen për: Automjetet me sistem paralajmërues të shpejtësisë“. Përveç kësaj, pajisjet opsionale ose specifike të automjetit dhe funksionet mund të jenë të shënuara me një yll „* “ ose nëpërmjet një shënimi të veçantë (p.sh. „në varësi të pajisjes“).

Simbolet dhe konvencionet e përshkrimit në manualin e përdorimit:

* Pajisje opsionale ose pajisje specifike për automjetin

▶ Kapitulli vazhdon në faqen tjetër.

⇨ *faqja 57* Referim indirekt në përshkrime ose fusha temash të tjera

⇨ ⚠ Referim në një mesazh „KUJDES“.

Të dhënat e drejtimeve si për shembull „majtas“, „djathtas“, „përpara“, „mbrapa“ i referohen drejtimit të udhëtimit të automjetit.

VINI RE

Tekstet me këtë simbol përmbajnë informacione mbi sigurinë tuaj dhe ju tërheqin vëmendjen për rreziqe të mundshme aksidentesh dhe lëndimesh.

KUJDES

Tekstet me këtë simbol ju tërheqin vëmendjen për dëme të mundshme në automjetin tuaj.

Udhëzim për ambientin

Tekstet me këtë simbol përmbajnë këshilla për mbrojtjen e mjedisit.

Udhëzim

Tekstet me këtë simbol përmbajnë informacione shtesë.

[1)] „Audi“ i referohet kompanisë AUDI AG, importuesit përkatës të shtetit, si dhe sipërmarrjeve të përbashkëta.

Hyrje e shpejtë

Informacionet online

myAudi

Nëpërmjet myAudi ju mund të hapni manualin tuaj të përdorimit me librin e bordit online të Audi në formën digjitale. Përveç kësaj merrni informacione mbi Audi Service, mbi mirëmbajtjen e automjetit tuaj ose planin digjital të shërbimeve.

Kusht: Ju keni krijuar një llogari myAudi. Ju keni krijuar në llogarinë tuaj myAudi automjetin tuaj.

- ▸ Hapni my.audi.com, ose
- ▸ Hapni aplikacionin myAudi në pajisjen tuaj celulare.

Udhëzim

Libri i bordit online i Audi dhe plani digjital i shërbimeve nuk janë të disponueshme në të gjitha vendet dhe jo për të gjitha pajisjet celulare.

Pyetjet më të shpeshta

Para udhëtimit

- – Si ta rregulloj sediljen? ⇨ *faqja 50*.
- – Si ta rregulloj timonin? ⇨ *faqja 52*.
- – Si funksionon leva e marsheve? ⇨ *faqja 86*.
- – Si funksionon freni elektromekanik i parkimit? ⇨ *faqja 95*.
- – Si ta rregulloj pasqyrën e jashtme? ⇨ *faqja 44*.
- – Si ta furnizoj me karburant automjetin tim? ⇨ *faqja 284*.
- – Si të shtoj AdBlue në automjetin tim me naftë? ⇨ *faqja 288*.
- – Si ta përdor fshirësen e xhamave me sensor shiu? ⇨ *faqja 46*.
- – Ku gjendet rezervuari i substancës për larjen e xhamave? ⇨ *faqja 295*.
- – Si mund ta ruaj presionin e gomave? ⇨ *faqja 314*.
- – Si udhëtoj unë me një rimorkio? ⇨ *faqja 106*.

Avari dhe raste emergjence

- – Si mund ta ndez automjetin tim me ndihmë të huaj? ⇨ *faqja 330*.
- – Ku gjendet trekëndëshi i emergjencës? ⇨ *faqja 322*.
- – Ku ta gjej setin e ndihmës së shpejtë? ⇨ *faqja 322*.
- – Ku ta gjej presionin e saktë të gomave? ⇨ *faqja 311*.
- – Me çfarë jastëkësh ajri është pajisur automjeti im? ⇨ *faqja 57*.
- – Ku gjenden pikat e rimorkimit në automjet? ⇨ *faqja 332*.

Funksione interesante

- – Si mund ta ruaj në mënyrë automatike distancën kundrejt automjetit që udhëton para? ⇨ *faqja 128*.
- – Si mund ta mbaj më lehtë korsinë e udhëtimit? ⇨ *faqja 141, Paralajmërimi i largimit nga korsia*.
- – Si mund të paralajmërohen gjatë largimit nga korsia e udhëtimit? ⇨ *faqja 141*.
- – Si mundë të përdor ndihmën e parkimit? ⇨ *faqja 150*.
- – Si mund t'i komandoj në mënyrë automatike dritat e gjata? ⇨ *faqja 40*.
- – Si mund të udhëtoj në mënyrë më komode? ⇨ *faqja 96, Asistenti i nisjes*.
- – Si mund ta monitoroj më lehtë këndin e vdekur gjatë ndërrimit të korsisë? ⇨ *faqja 147, Audi side assist*.
- – Si mund ta ndryshoj ndriçimin e instrumenteve dhe ekraneve? ⇨ *faqja 43*.
- – Si mund ta përshtat karakterin e automjetit tim me situatën e udhëtimit dhe gjendjen personale shpirtërore? ⇨ *faqja 101, Audi drive select*.

Ekrani dhe përdorimi

- – Si ta ndez sistemin e informimit dhe argëtimit dhe ta rregulloj volumin? ⇨ *faqja 162*.
- – Si të navigoj përmes menyve të sistemit të informimit dhe argëtimit? ⇨ *faqja 164, Principi i përdorimit MMI*. ▸

81B012790AG

– Si mund t'i vendos shkronjat dhe numrat me shkrim dore? ⇨ *faqja 165, MMI touch*.
– Si ta përdor funksionin e kërkimit në sistemin e informimit dhe argëtimit? ⇨ *faqja 172, Kërkimi i lirë*.
– Si mund ta përdor sistemin e informimit dhe argëtimit me zë? ⇨ *faqja 181*.
– Cilat funksione mund të përdor me butonat në timon? ⇨ *faqja 17*.
– Si ta rregulloj datën dhe orën? ⇨ *faqja 274*.

Sistemi i informimit dhe argëtimit

– Si mund ta lidh telefonin tim celular, për të përdorur sistemin viva-voce? ⇨ *faqja 191*.
– Si mund ta karikoj pa kabllo baterinë e telefonit tim celular? ⇨ *faqja 195, Përdorimi i Audi phone box*.
– Si mund t'i përdor aplikacionet e caktuara të Smartphone tim nëpërmjet sistemit të informimit dhe argëtimit? ⇨ *faqja 272, Audi Smartphone Interface*.
– Si mund t'i hap informacionet online? ⇨ *faqja 209, Audi connect (Audi connect)*.
– Si mund ta përdor Wi-Fi hotspot? ⇨ *faqja 212*.
– Çfarë mundësish kam për të dhënë një destinacion navigimi? ⇨ *faqja 222*.
– Si i përdor funksionet e hartave? ⇨ *faqja 234*.
– Si mund t'i shfaq informacionet e trafikut? ⇨ *faqja 240*.
– Si mund të dëgjoj radio? ⇨ *faqja 244*.
– Si mund të luaj media? ⇨ *faqja 262*.
– Si mund të luaj muzikë nga telefoni im celular përmes sistemit të informimit dhe argëtimit? ⇨ *faqja 254, Bluetooth Audio player*.

Këshilla dhe truke

– Si mund ta hap automjetin nga brenda në mënyrë që të hipin pasagjerët? ⇨ *faqja 27*.
– Si mund t'i hap të gjitha xhamat nga jashtë me anën e çelësit me valë? ⇨ *faqja 37, Hapja/mbyllja komode*.
– Si mund ta konfiguroj pozicionin e hapjes së derës së bagazhit? ⇨ *faqja 35*.
– Si mund t'i përdor në mënyrë sinkrone të dyja anët e kondicionerit? ⇨ *faqja 76*.
– Si mund ta fik në jastëkun e ajrit të pasagjerit para? ⇨ *faqja 60*.
– Si e fiksoj një sistem mbajtës për fëmijët? ⇨ *faqja 60*.
– Çfarë duhet të kem parasysh gjatë udhëtimit përmes një impianti larjeje? ⇨ *faqja 315*.
– Si mund të udhëtoj në mënyrë efikase dhe duke mbrojtur mjedisin? ⇨ *faqja 91*.
– Si mund ta thërras datën tjetër të shërbimit? ⇨ *faqja 306*.

Kruskoti



Fig. 1 Cockpit

1. Doreza e hapjes së derës
2. Butoni i mbylljes qendrore 27
3. Vrimat për nxjerrjen e ajrit 78
4. Leva e përdorimit për:
   – Sinjalet dhe dritat e gjata 40
   – Asistenti i dritave të gjata 40
   – Paralajmërimi i ndryshimit të korsisë 141
   – Udhëheqja në korsi 133
5. Timoni multifunksional me:
   – Bori
   – Jastëk ajri për drejtuesin e mjetit . 57
   – Butonat e përdorimit 17, 24
   – Levat e kambios në timon 88
6. Kruskoti 16
7. Leva e përdorimit të sistemit të fshirjes/larjes së xhamave 46
8. Ekrani i sistemit të informimit dhe argëtimit 163
9. Sirtari që mbyllet në kruskot me:
   – Mbajtës çelësi për jastëkun e ajrit të pasagjerit para 60
   – Drive-t për CD, DVD, kartat SIM/SD 252, 210
10. Jastëku i ajrit të pasagjerit para . . . 57
11. Në varësi të pajisjes buton për:
   – drive select 101
   – Sistemi Start-Stop 92
   – Asistenti i parkimit 159
   – Ndihma e parkimit 151
   – Bllokazhi 42
   – Kontrolli elektronik i stabilizimit (ESC) 103
   – Ekrani i sistemit të informimit dhe argëtimit 163
12. Kondicioneri 73
13. Në varësi të pajisjes:
   – Ndezësi i cigareve 67
   – Priza 67
14. Në varësi të pajisjes: ▶

– Leva e marsheve (Kambio automatike) 86
– Leva e marsheve (kambio manuale) 86
15 Mbajtësi i pijeve 68
16 Butoni i ndezjes/fikjes për MMI . . . 162
17 Paneli i kontrollit MMI 162
18 Asistenti i nisjes 96
19 Mbështetësja qendrore e krahut me sirtarin e ruajtjes, në varësi të pajisjes me:
– Audi music interface 258
– Hyrja AUX/kutia e karikimit USB . 260
– Audi smartphone interface 272
– Audi phone box 195
20 Frena elektromekanike e parkimit . 95
21 Butoni START ENGINE STOP 82
22 Tavlla e duhanit 67
23 Audi music interface 258
24 Kolona e timonit, në varësi të pajisjes me:
– Çelësi i kuadrit 83
– Ndezja e motorit në rastin e një defekti 84
25 Konfigurimi i timonit 52
26 Leva e përdorimit për:
– Sistemet e rregullimit të shpejtësisë 126
– Asistentët e drejtimit që përshtaten 128
27 Ndriçimi i instrumenteve 43
28 Çelësi i dritave 39
29 Hapja e kofanos 294
30 Butoni për:
– Dritat për të gjitha llojet e motit . 39
– Drita e pasme e mjegullës 39
31 Butoni për derën e bagazhit 34
32 Rregullimi i pasqyrave të jashtme . 44
33 Butonat për:
– Ngritësit e xhamave 37
– Siguresa e fëmijëve 36

Udhëzim

– Disa nga pajisjet e listuara këtu i përkasin vetëm varianteve të caktuara të modeleve ose janë pajisje shtesë.
– Tek automjetet me timon në krahun e djathtë* radhitja e elementëve të përdorimit nuk përputhet pjesërisht me radhitjen e treguar në ⇨ *faqja 10*. Por simbolet që markojnë elementet e përdorimit janë të njëjta.

Pasqyra e dritave të kontrollit

Përshkrimi

Dritat e kontrollit pulsojnë ose ndriçojnë në kruskot. Ato tregojnë funksione ose defekte të funksioneve. Disa drita paralajmëruese dhe kontrolli ndriçojnë gjatë ndezjes së kuadrit dhe duhet të fiken kur motori është i ndezur ose gjatë udhëtimit.

Në rastin e disa dritave të kontrollit mund të shfaqen udhëzime për udhëtimin ose të dëgjohen sinjale paralajmëruese. Dritat e kontrollit dhe këshillat e udhëtimit mund të mbulohen nga ekranet e tjera. Për t'i shfaqur përsëri ato në sistemin e informacionit të drejtuesit të mjetit*, zgjidhni në timonin multifunksional skedën e dytë të udhëzimeve për drejtuesin e mjetit ⇨ *faqja 17*.

Disa drita kontrolli në ekran paraqiten me disa ngjyra.

⚠ Dritat qendrore të kontrollit

Nëse ndriçon drita e kontrollit ⚠ ose ⚠, respektoni udhëzimet për drejtuesin e mjetit në kruskot.

Vlen për: Automjetet me ekranin me një ngjyrë

Nëse shfaqet një udhëzim i drejtuesit të mjetit bashkë me një dritë qendrore të kontrollit ⚠ ose ⚠, drita qendrore e kontrollit vizualizon përparësinë e paralajmërimit. Nëse shfaqet gjithashtu një dritë e bardhë e kontrollit, atëherë drita qendrore e kontrollit paraqet ngjyrën e saj ▶

të vërtetë. Nëse shfaqet p.sh. bashkë me , lexoni përshkrimin te .

Përmbledhje

Në varësi të pajisjes së automjetit janë të disponueshme dritat e mëposhtme të kontrollit:

Dritat e kuqe të kontrollit

	Drita qendrore e kontrollit ⇨ *faqja 11*, kruskot ⇨ *faqja 16*
	Sistemi i ftohjes ⇨ *faqja 19*, ⇨ *faqja 299*, ⇨ *faqja 299*, ⇨ *faqja 300*
	Rripi i sigurisë ⇨ *faqja 56*
	Kambioja ⇨ *faqja 89*
	Ndalimi i motorit gjatë udhëtimit ⇨ *faqja 91*
	Impianti i frenimit ⇨ *faqja 94*, ⇨ *faqja 301*, Frena elektromekanike e parkimit ⇨ *faqja 97*
	Frena elektromekanike e parkimit ⇨ *faqja 95*
	Sistemi i drejtimit ⇨ *faqja 102*
	Bllokimi i sistemit të drejtimit ⇨ *faqja 102*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 130*, Kërkesa e marrjes së kontrollit të frenave ⇨ *faqja 134*, Monitorimi i nisjes ⇨ *faqja 138*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 130*, ⇨ *faqja 134*
	Kërkesa për marrjen e drejtimit të mjetit (Asistenti i udhëtimit që përshtatet) ⇨ *faqja 134*
	Paralajmërimi i distancës ⇨ *faqja 140*
	Paralajmërimi i ndryshimit të korsisë ⇨ *faqja 141*
	Paralajmërimi i ndryshimit të korsisë ⇨ *faqja 141*
	Pre sense ⇨ *faqja 144*, ⇨ *faqja 145*
	Asistenti i emergjencës ⇨ *faqja 149*
	AdBlue ⇨ *faqja 287*
	AdBlue ⇨ *faqja 287*
	Kofano ⇨ *faqja 294*
	Presioni i vajit të motorit ⇨ *faqja 296*
	Rrjeti i bordit ⇨ *faqja 302*

Dritat e verdha të kontrollit

	Drita qendrore e kontrollit ⇨ *faqja 11*
	Kufizimi i numrit të xhirove ⇨ *faqja 20*
	Kufizimi i numrit të xhirove ⇨ *faqja 20*, sistemi i lëvizjes së mjetit ⇨ *faqja 91*

EPC	Kufizimi i numrit të xhirove ⇨ *faqja 20*, sistemi i lëvizjes së mjetit ⇨ *faqja 91*
	Mbyllja qendrore ⇨ *faqja 27*
	Bateria në çelësin me valë ⇨ *faqja 32*
	Kontrolli i dështimit të llambave ⇨ *faqja 42*
	Dritat e zbehura ⇨ *faqja 42*
	Sensori i dritës/shiut ⇨ *faqja 42*, ⇨ *faqja 48*
	Rregullimi i distancës së ndriçimit ⇨ *faqja 42*
	Fshirëset e xhamave ⇨ *faqja 48*
	Sistemet e sigurisë ⇨ *faqja 58*
	Nxehja paraprake ⇨ *faqja 83*
	Sistemi i ndezjes së motorit ⇨ *faqja 84*
	Çelësi komod ⇨ *faqja 84*
	Asistenti i nisjes në malore ⇨ *faqja 86*
	Kambio ⇨ *faqja 89*, friksioni ⇨ *faqja 89*
	Ferrota e frenave ⇨ *faqja 94*
	Frena elektromekanike e parkimit ⇨ *faqja 97*
	Rregullimi i amortizatorëve ⇨ *faqja 102*
	Sistemi i drejtimit ⇨ *faqja 102*
	Bllokimi i sistemit të drejtimit ⇨ *faqja 102*

	Sistemi elektronik i stabilizimit ⇨ *faqja 104*, ⇨ *faqja 105*
ESC OFF	Sistemi elektronik i stabilizimit ⇨ *faqja 105*
	Sistemi elektronik i stabilizimit ⇨ *faqja 105*
	Sistemi anti bllokues ⇨ *faqja 105*
	Kërkesa për marrjen e drejtimit të mjetit (Asistenti i udhëtimit që përshtatet) ⇨ *faqja 134*, Kërkesa për marrjen e drejtimit të mjetit (Paralajmërim i braktisjes së korsisë) ⇨ *faqja 142*
	Paralajmërimi i ndryshimit të korsisë ⇨ *faqja 141*, ⇨ *faqja 143*
	Pre sense ⇨ *faqja 144*, ⇨ *faqja 146*
	Audi side assist ⇨ *faqja 148*
	Ndihma për parkimin ⇨ *faqja 153*
	Asistenti i trafikut diagonal mbrapa ⇨ *faqja 156*
	Asistenti i parkimit ⇨ *faqja 161*
	Funksioni i thirrjes së emergjencës ⇨ *faqja 220*
	Sistemi i kontrollit të gazeve ⇨ *faqja 284*, ⇨ *faqja 292*
	Sistemi i furnizimit me karburant ⇨ *faqja 284*
	AdBlue ⇨ *faqja 287*

▶

	AdBlue ⇨ *faqja 287*
	Filtri i grimcave ⇨ *faqja 291*
	Niveli i vajit të motorit (MIN) ⇨ *faqja 296*
	Sensori i vajit të motorit ⇨ *faqja 296*, ⇨ *faqja 297*
	Kërkesa për ngrohjen e motorit ⇨ *faqja 296*
	Rrjeti i bordit ⇨ *faqja 302*
	Niveli i ujit të larjes së xhamave ⇨ *faqja 306*
	Presioni i gomave ⇨ *faqja 314*
	Presioni i gomave ⇨ *faqja 314*

Drita të tjera kontrolli

	Sistemi i sinjaleve ⇨ *faqja 40*, ⇨ *faqja 42*
	Sistemi i sinjaleve ⇨ *faqja 40*, ⇨ *faqja 42*
	Rripi i sigurisë mbrapa ⇨ *faqja 56*
	Sistemi Start-Stop ⇨ *faqja 92*
	Asistenti i nisjes ⇨ *faqja 96*
	Sistemi i sinjaleve të rimorkios ⇨ *faqja 107*
	Sistemi i rregullimit të shpejtësisë ⇨ *faqja 126*
	Kufizuesi i shpejtësisë ⇨ *faqja 126*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 130*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 130*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 130*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 130*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 130*
	Asistenti i efikasitetit ⇨ *faqja 135*
	Asistenti i efikasitetit ⇨ *faqja 135*
	Asistenti i efikasitetit ⇨ *faqja 135*
	Asistenti i efikasitetit ⇨ *faqja 135*
	Asistenti i efikasitetit ⇨ *faqja 135*
	Asistenti i efikasitetit ⇨ *faqja 135*
	Asistenti i efikasitetit ⇨ *faqja 135*
	Paralajmërimi i ndryshimit të korsisë ⇨ *faqja 141*
	Paralajmërimi i ndryshimit të korsisë ⇨ *faqja 141*, ⇨ *faqja 143*
	Dritat e gjata ⇨ *faqja 40*, ⇨ *faqja 41*
	Asistenti i dritave të gjata ⇨ *faqja 40*
	Asistenti i dritave të gjata ⇨ *faqja 40*, ⇨ *faqja 42*
	Rripi i sigurisë mbrapa ⇨ *faqja 56*

	Rripi i sigurisë mbrapa ⇨ *faqja 56*
	Ngrohja/ajrimi stacionar ⇨ *faqja 79*, ⇨ *faqja 81*
	Çelësi komod ⇨ *faqja 84*
	Friksioni ⇨ *faqja 89*
	Sistemi Start-Stop ⇨ *faqja 92*
	Sistemi Start-Stop ⇨ *faqja 93*
	Frena elektromekanike e parkimit ⇨ *faqja 97*
	Frenat ⇨ *faqja 97*
	Sistemi i paralajmërimit të shpejtësisë ⇨ *faqja 119*
	Dallimi i shenjave të qarkullimit i bazuar në kamera ⇨ *faqja 122*
	Këshilla e pushimit ⇨ *faqja 123*
	Sistemi i rregullimit të shpejtësisë ⇨ *faqja 128*
LIM	Kufizuesi i shpejtësisë ⇨ *faqja 128*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 130*, ⇨ *faqja 133*
	Kontrolli që përshtatet ⇨ *faqja 135*, Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 139*
	Asistenti i udhëtimit që përshtatet ⇨ *faqja 136*, ⇨ *faqja 139*
	Paralajmërimi i ndryshimit të korsisë ⇨ *faqja 141*
	Kërkesa për marrjen e drejtimit të mjetit (paralajmërimi i ndryshimit të korsisë) ⇨ *faqja 142*
	Paralajmërimi i ndryshimit të korsisë ⇨ *faqja 143*, ⇨ *faqja 143*
	Pre sense ⇨ *faqja 144*, ⇨ *faqja 146*
	Pre sense ⇨ *faqja 144*, ⇨ *faqja 145*
	Audi side assist ⇨ *faqja 148*
	Ndihma për parkimin ⇨ *faqja 153*
	Asistenti i trafikut diagonal mbrapa ⇨ *faqja 156*
	Asistenti i parkimit ⇨ *faqja 161*
	AdBlue ⇨ *faqja 287*
	AdBlue ⇨ *faqja 287*

Kruskoti

Pasqyrimi i kruskotit

Kruskoti është qendra e informimit për drejtuesin e mjetit.

Vlen për: Automjete me Audi virtual cockpit
Fig. 2 Pasqyrimi i kruskotit

Vlen për: Automjete me kruskot analog
Fig. 3 Pasqyrimi i kruskotit

Në varësi të pajisjes së automjetit në kruskot tregohen përmbajtjet e mëposhtme:

1. Treguesi
   – Temperatura e substancës së ftohjes 19
   – Treguesi i boost 21
2. Instrumenti i rrumbullakët i majtë
   – Matësi i numrit të xhirove 20
3. Zona e skedave 17
4. Zona qendrore 17
5. Shiriti i statusit (me një ose me dy rreshta)
6. Butoni i kthimit në gjendjen fillestare për numëruesin e kilometrave ditore 20
7. Instrumenti i rrumbullakët i djathtë
   – Treguesi komod
   – Tahometri
8. Treguesi
   – Sasia e karburantit ..... 284 ▶

(9) Treguesi sekondar i djathtë me tahometër

(10) Treguesi sekondar i majtë me:

– Marsh 86
– Modaliteti Audi drive select 101

VINI RE

Vlen për: Automjete me Audi virtual cockpit

Nëse ekziston një defekt i rëndë në sistem, ekrani mund të fiket. Gjatë këtij procesi mund të ndriçojë edhe drita e kontrollit ⚠. Parkojeni automjetin në mënyrë të sigurt. Merrni ndihmë të specializuar.

Udhëzim

– Në faqet e mëposhtme do të shfaqen kryesisht paraqitje të kruskotit analog me shumë ngjyra*. Në rastin e kruskotit me një ngjyrë ose në rastin e Audi virtual cockpit* paraqitja ose pozicioni i elementeve të shfaqur mund të shmanget.
– Njësitë matëse p.sh. për temperaturën ose shpejtësinë mund t'i ndryshoni në sistemin e informimit dhe argëtimit ⇨ *faqja 274*.
– Nëse kemi një defekt në kruskot, në zonën e tregimit të numëruesit ditor të kilometrave tregohet **DEF**. Riparojeni defektin sa më shpejt të jetë e mundur.
– Në varësi të modelit të automjetit kur drita është e fikur dhe kuadri i ndezur ndizet ndriçimi i instrumenteve (treguesit dhe shkallët). Me rënien e ndriçimit të mjedisit, ndriçimi i shkallëve reduktohet në mënyrë automatike dhe fiket eventualisht plotësisht. Ky funksion duhet ta kujtojë drejtuesin e mjetit, që të ndezë në kohën e duhur dritën e zbehur.

Principi i përdorimit

Vlen për: Timonin multifunksional plus



Fig. 4 Pamja e sistemit të informacionit të drejtuesit të mjetit (Audi virtual cockpit)

Fig. 5 Ana e majtë e timonit multifunksional plus

Në kruskot informacionet organizohen në skeda të ndryshme (1). Përmbajtjet e skedave tregohen në zonën qendrore (2).

Kusht: Kuadri është i ndezur.

Përzgjedhja e skedës

▸ Shtypni butonin ◁ / ▷ (3) derisa të zgjidhet skeda e dëshiruar.

Kthimi te funksioni i një niveli më lart

▸ Shtypni butonin ⮌ (5).

Hapja/mbyllja e menysë

▸ Shtypni butonin e majtë ose të djathtë të komandimit ❳ ose ❲ (6).

Zgjedhja dhe konfirmimi i funksionit

Kusht: Po tregohet një meny ose një listë.

▸ Për të zgjedhur një funksion, rrotullojeni rulin e majtë (7) në funksionin e dëshiruar.
▸ Për ta konfirmuar një zgjedhje, shtypni rulin e majtë (7). ▶

Ndryshimi i pamjes

▸ Shtypni butonin VIEW (4) ⇨ *faqja 19*.

Në varësi të pajisjes së automjetit janë të disponueshme skedat e mëposhtme të kontrollit:

Skeda e 1-të	Funksionet e automjetit ⇨ *faqja 21*
Skeda e 2-të	Këshilla udhëtimi (tregohet vetëm nëse tregohet të paktën një dritë kontrolli/një këshillë udhëtimi)
Skeda e 3-të	Radio ⇨ *faqja 175* Mediat ⇨ *faqja 175*
Skeda e 4-të	Telefoni ⇨ *faqja 176*
Skeda e 5-të	Navigimi ⇨ *faqja 177*

Butonat e komandimit

Vlen për: Automjete me Audi virtual cockpit



Fig. 6 Menyja e zgjedhjes dhe menyja e opsioneve

Butoni i majtë i komandimit

– **Thirrja/mbyllja e menysë së zgjedhjes**: Në timonin multifunksional shtypni gjithnjë butonin e majtë të komandimit ⇨ *fig. 6*. Në menynë e zgjedhjes mund të zgjidhni dhe konfirmoni një funksion nëpërmjet rulit të djathtë (p.sh. zgjidhni diapazonin e frekuencave).

Butoni i djathtë i komandimit

– **Thirrja/mbyllja e menysë së opsioneve**: Në timonin multifunksional shtypni gjithnjë butonin e djathtë të komandimit ⇨ *fig. 6*. Në menynë e opsioneve mund të kryeni funksionet si dhe cilësimet në varësi të kontekstit nëpërmjet rulit të majtë (p.sh. zgjerimi i informacionit të dërgimit).

Udhëzim

Nëse është në dispozicion një meny e zgjedhjes ose opsioneve, atëherë varet nga funksioni i zgjedhur.

Ndryshimi i pamjes

Vlen për: Automjete me Audi virtual cockpit

Fig. 7 Pamja standarde: klasike/sportive*

Fig. 8 Pamja e zgjeruar

Ndryshimi i pamjes

- Shtypni butonin VIEW (4) ⇨ *faqja 17, fig. 5*, për të kaluar nga pamja standarde ⇨ *fig. 7* në pamjen e zgjeruar ⇨ *fig. 8*. Për t'u kthyer te pamja standarde, shtypni përsëri butonin VIEW.

Përcaktimi i pamjes standarde

Vlen për: Automjetet me pamje sportive

Në varësi të pajisjes së automjetit ju mund të zgjidhni ndërmjet pamjes klasike dhe pamjes sportive.

- Thirrni skedën e parë të funksioneve të automjetit nëpërmjet butonit ◁ ▷ në timonin multifunksional.
- Zgjidhni në timonin multifunksional: Butoni i majtë i komandimit > **Layout** (Pamja) > **Layout Sport** (Pamja sportive) ose **Layout Classic** (Pamja klasike).

Konfigurimi i treguesit sekondar

Në varësi të pajisjes së automjetit ndryshojnë ekranet sekondare që mund të përzgjidhen.

- Thirrni skedën e parë të funksioneve të automjetit nëpërmjet butonit ◁ ▷ në timonin multifunksional.
- Zgjidhni në timonin multifunksional: Butoni i djathtë i komandimit > **Secondary display** (Treguesi sekondar).
- Zgjidhni ekranin e dëshiruar sekondar.

Udhëzim

Vlen për: Automjetet me pamje sportive

Përpara nisjes së udhëtimit konfiguroni gjithmonë pamjen e dëshiruar standarde, meqë asnjë funksion i ekranit nuk është në dispozicion për disa sekonda.

Treguesi i temperaturës së substancës ftohëse

Vlen për: Automjete me tregues të temperaturës së substancës ftohëse

Treguesi i temperaturës së substancës ftohëse (1) ⇨ *faqja 16* punon vetëm kur kuadri është i ndezur. Për të mënjanuar dëmtime të motorit, kushtoni vëmendje kështillave të mëposhtme mbi zonat e temperaturës.

Zona e ftohtë

Nëse ndriçojnë LED-të vetëm në zonën e poshtme të shkallës, motori nuk e ka arritur ende temperaturën e punës. Mënjanoni xhirot e larta të motorit, gazin e plotë dhe ngarkesën e fortë të motorit.

Zona normale

Motori e ka arritur temperaturën e tij të punës, nëse ndriçojnë LED-të në zonën e mesit të shkallës. Nëse shfaqet drita e kontrollit në ekranin e kruskotit, temperatura e substancës ftohëse është tepër e lartë ⇨ *faqja 299*. ▶

KUJDES

– Fenerët shtesë dhe pjesë të tjera shtesë të montuara para vrimës për hyrjen e ajrit ftohës përkeqësojnë efektin ftohës të substancës ftohëse. Në temperatura të jashtme të larta dhe ngarkesë të madhe të motorit ekziston më pas rreziku i një mbinxehje të motorit!
– Spojleri i përparmë kujdeset edhe për shpërndarjen e duhur të ajrit të ftohjes gjatë udhëtimit. Nëse spojleri është i dëmtuar, përkeqësohet efekti ftohës dhe ekziston rreziku i një mbinxehje të motorit! Merrni ndihmë të specializuar.

Udhëzim

Vlen për: Automjete me motor me naftë

Për shkak të rendimentit të lartë të këtyre motorëve, në temperatura të jashtme ftohta mund të ndodhë që temperatura e punës të mos arrihet gjithmonë. Kjo gjë është normale dhe prandaj e padëmshme.

Matësi i xhirove

Matësi i xhirove (2) ⇨ *faqja 16* tregon xhirot e motorit në minutë. Fillimi i zonës së kuqe te matësi i xhirove markon për të gjitha marshet numrin maksimal të lejuar të xhirove të motorit të shtruar dhe që ka arritur temperaturën e punës. Para arritjes së kësaj zone duhet që të fusni marshin tjetër më të lartë, të zgjidhni pozicionin D/S të marshit ose të hiqni këmbën nga pedali i gazit.

Kufizimi i numrit të xhirove

Vlen për: Automjetet me kufizimin e numrit të xhirove

Nëse ndriçon drita e kontrollit, motori kufizohet automatikisht në numrin e xhirove të treguar në kruskot. Në këtë mënyrë komponentët e motorit mbrohen p.sh. në rastin e një ndezje të ftohtë ose kundrejt një mbinxehje.

Kufizimi i numrit të xhirove hiqet, nëse ju në temperaturë normale të motorit e hiqni këmbën për një kohë të shkurtër nga pedali i gazit.

Nëse kufizimi i numrit të xhirove u shkaktua për shkak të një defekti në sistemin e kontrollit të motorit, ndriçon gjithashtu edhe drita e kontrollit ose EPC. Mbani parasysh që numri i xhirove p.sh. gjatë uljes së marsheve të mos ngrihet mbi numrin e treguar të xhirove. Shkoni menjëherë te një ofiçinë e specializuar dhe riparoni defektin.

KUJDES

Treguesi i matësit të numrit të xhirove (2) lejohet që të shkojë vetëm për një kohë të shkurtër në zonën e kuqe: Rrezik për një dëmtim të motorit! Fillimi i zonës së kuqe në shkallë varet nga motori përkatës.

Numëruesi i kilometrave

Në rreshtin e statusit (5) ⇨ *faqja 16* tregohen numëruesi ditor dhe i përgjithshëm i kilometrave.

Numëruesi ditor i kilometrave tregon distancën, e cila u krye pas rikthimit për herë të fundit në gjendjen fillestare. Me atë mund të maten distanca të shkurtra. Numëruesi i përgjithshëm i kilometrave tregon distancën, të cilën automjeti ka kryer në total.

Rikthimi në gjendjen fillestare i numëruesit ditor të kilometrave

▸ Për ta kthyer në zero numëruesin ditor të kilometrave, shtypni butonin e kthimit në gjendjen fillestare (6) ⇨ *faqja 16*.

Treguesi i temperaturës së jashtme

Në rreshtin e statusit (5) ⇨ *faqja 16* tregohet temperatura e jashtme.

Kur automjeti ka ndaluar ose kur udhëton me shpejtësi shumë të ulët temperatura e treguar në kruskot, për shkak të nxehtësisë së rrezatuar të motorit mund të jetë më e lartë se temperatura e jashtme faktike.

Në temperatura nën +5 °C para treguesit të temperaturës shfaqet një kristal akulli ⇨ .

VINI RE

Mos e përdorni kurrë treguesin e temperaturës së jashtme, që të bindeni që ▸

rrugët janë të lira nga akulli. Kushtojini vëmendje faktit që edhe në temperatura të jashtme përreth +5°C mund të ekzistojë akull - Rrezik aksidenti për shkak të formimit të akullit!

Treguesi i temperaturës së vajit të motorit

Vlen për: Automjetet me tregues të temperaturës së vajit

Në varësi të pajisjes së automjetit në kruskot tregohet temperatura e vajit të motorit me anën e një shiriti.

Vlen për: Automjetet me kruskot analog: Thirrni Laptimer ⇨ *faqja 123*.

▸ Vlen për: Automjetet me Audi virtual cockpit:Thirrni skedën e funksioneve të automjetit dhe kaloni në pamjen e zgjeruar ose kaloni në pamjen sportive* ⇨ *faqja 19*.

Në rastin e temperaturave të ulëta të vajit të motorit në kruskot shfaqet treguesi --- °C.

Motori ka arritur temperaturën e tij të punës nëse temperatura e vajit të motorit është ndërmjet 80°C dhe 120°C në rastin e mënyrës normale të udhëtimit. Kur motori ngarkohet shumë dhe temperaturat e jashtme janë të larta, temperatura e vajit të motorit mund të vazhdojë të ngrihet. Kjo gjë nuk është shqetësuese për sa kohë dritat e kontrollit ose nuk ndriçojnë.

Treguesi i boost

Vlen për: Automjete me tregues të boost

Niveli aktual i ngarkesës së motorit (që do të thotë presioni momental i ngarkimit) tregohet me anën e një shiriti.

▸ Vlen për: Automjetet me Audi virtual cockpit:Thirrni skedën e funksioneve të automjetit dhe kaloni në pamjen e zgjeruar ose kaloni në pamjen sportive* ⇨ *faqja 19*.

Funksionet e automjetit

Përmbledhje

Në skedën e parë të sistemit të informimit të drejtuesit të mjetit tregohet kompjuteri i bordit.

Në varësi të pajisjes së automjetit mund të hapen funksione të tjera të automjetit.

▸ Shtypni butonin e majtë të komandimit.

– Kompjuteri i bordit ⇨ *faqja 21*, ose ⇨ *faqja 22*
– Programi i eficencës ⇨ *faqja 23*
– Tahometrin digjital
– Laptimer ⇨ *faqja 123*
– Asistenca
– Shenjat e qarkullimit ⇨ *faqja 119*
– Treguesi i reduktuar
– Kohët e xhirove ⇨ *faqja 123*
– Statistika ⇨ *faqja 124*
– Layout ⇨ *faqja 19*

Kompjuteri i bordit (Audi virtual cockpit)

Vlen për: Automjete me Audi virtual cockpit

Fig. 9 Kruskoti: Treguesi i konsumit

Vendosja e vlerave në zero

Kusht: Është zgjedhur treguesi **Consumption** (Konsumi), **Short-term memory** (Memoria afatshkurtër) ose **Long-term memory** (Memoria afatgjatë).

▸ Për të vendosur në zero vlerat e memories përkatëse, shtypni rulin e majtë në timonin multifunksional për një sekondë. Ose
▸ Zgjidhni në timonin multifunksional: Butoni i djathtë i komandimit > **Reset values*** (Rivendosja e vlerave).

Në varësi të pajisjes së automjetit janë të disponueshme treguesit e mëposhtëm:

– Data dhe ora ⇨ *faqja 274*
– Konsumin mesatar ⇨ *faqja 22*
– Autonomia e AdBlue ⇨ *faqja 286*

– Memoria afatshkurtër - Përmbledhja
– Memoria afatgjatë - Përmbledhja
– Konsumatorët e energjisë ⇨ *faqja 22*
– Asistenca e drejtuesit të mjetit ⇨ *faqja 126*
– Dallimi i shenjave të qarkullimit

Memoria afatshkurtër grumbullon informacionet e udhëtimit nga ndezja deri në fikjen e kuadrit. Nëse udhëtimi vazhdohet brenda 2 orëve nga fikja e kuadrit, vlerat e ardhura rishtazi përfshihen në përllogaritjen e informacioneve aktuale të udhëtimit.

Ndërkohë që memoria afatgjatë ndryshe nga memoria afatshkurtër nuk fshihet automatikisht. Në këtë mënyrë mund të përcaktoni vetëm periudhën kohore për vlerësimin e informacioneve të udhëtimit.

Konsumi mesatar

Konsumi momental mund të tregohet me një tregues me shirit. Për më tepër tregohet konsumin mesatar nga memoria afatshkurtër. Nëse shiriti është jeshil, automjeti juaj kursen energji (p.sh. nëpërmjet rikuperimit).

Konsumatorët e energjisë*

Në pamjen **Energy consumers** (Konsumatorët e energjisë) listohen konsumatorë shtesë, të cilët ndikojnë në konsumin aktual të karburantit. Monitori tregon deri në tre konsumatorë energjie. Konsumatori më i madh qëndron në pozicionin më të sipërm. Nëse janë ndezur më shumë se tre konsumatorë, tregohen konsumatorët aktual më të mëdhenj. Përveç kësaj, një shkallë ju informon mbi shumën aktuale të të gjithë konsumatorëve shtesë.

Këshilla kursimi*

Vlen për: Automjetet me Audi drive select dhe Modus efficiency

Në modalitetin **efficiency** (Eficenca) në situata të caktuara të konsumit shfaqen për një kohë të shkurtër në ekranin e kruskotit këshillat e kursimit. Nëse mund t'i ndiqni këto këshilla kursimi, ju mund të reduktoni konsumin e karburantit të automjetit tuaj.

Për të shuar një këshillë kursimi menjëherë pas shfaqjes, shtypni rulin e majtë në timonin multifunksional.

Ndizni/fikni këshillat e kursimit: Zgjidhni në sistemin e informimit dhe argëtimit: Butoni MENU > **Car** (Automjeti) > **Audi drive select** (Audi drive select). Zgjidhni **efficiency** (eficenca) > butoni i djathtë i komandimit > **Economy tips** (Këshilla kursimi).

Udhëzim

– Data, ora, formati i orës dhe i datës mund të konfigurohen në sistemin e informimit dhe argëtimit ⇨ *faqja 274*.
– Këshillat e kursimit nuk tregohen në çdo kohë, por në mënyrë të synuar në distanca kohore më të mëdha.
– Nëse nuk keni shfaqur një këshillë kursimi, atëherë kjo shfaqet përsëri vetëm atëherë, nëse e ndizni përsëri kuadrin.

Kompjuteri i bordit (Kruskoti analog)

Vlen për: Automjetet me kruskot analog

Fig. 10 Kruskoti: Treguesi i konsumit

Në varësi të pajisjes së automjetit mund të thirrni në kompjuterin e bordit tregues të ndryshëm ose tregohet një gamë e përcaktuar te informacionet, p.sh. numëruesi i kilometrave.

Vendosja e vlerave në zero

Kusht: Është zgjedhur treguesi **Consumption** (Konsumi), **Short-term memory** (Memoria afatshkurtër) ose **Long-term memory** (Memoria afatgjatë).

▸ Për të vendosur në zero vlerat e memories përkatëse, shtypni rulin e majtë në timonin multifunksional për një sekondë. ▶

Kompjuteri i bordit

Në kompjuterin e bordit, duke rrotulluar rulin e majtë në timonin multifunksional, ju mund të hapni njëri pas tjetrit treguesit e mëposhtëm:

– Data ⇨ *faqja 274*
– Autonomia e mbetur
– Autonomia e AdBlue* ⇨ *faqja 286*
– Memoria afatshkurtër 1
– Konsumi mesatar
– Memoria afatgjatë 2
– Temperatura e vajit të motorit*

Memoria afatshkurtër grumbullon informacionet e udhëtimit nga ndezja deri në fikjen e kuadrit. Nëse udhëtimi vazhdohet brenda 2 orëve nga fikja e kuadrit, vlerat e ardhura rishtazi përfshihen në përllogaritjen e informacioneve aktuale të udhëtimit.

Ndërkohë që memoria afatgjatë ndryshe nga memoria afatshkurtër nuk fshihet automatikisht. Në këtë mënyrë mund të përcaktoni vetëm periudhën kohore për vlerësimin e informacioneve të udhëtimit.

Udhëzim

Data, ora, formati i orës dhe i datës mund të konfigurohen në sistemin e informimit dhe argëtimit ⇨ *faqja 274*.

Programi i eficencës

Vlen për: Automjetet me programin e eficencës

Vendosja e vlerave në zero

▸ Për të vendosur në zero vlerat e memories përkatëse, shtypni rulin e majtë në timonin multifunksional për një sekondë.

Programi i eficencës mund të ndihmojë për të kursyer karburant. Ai vlerëson informacionet e udhëtimit për temën konsumi i karburantit dhe tregon konsumatorët shtesë dhe rekomandimet për marshet. Këshillat e kursimit japin këshilla për një mënyrë efikase të udhëtimit.

Të dhënat e distancës dhe konsumit i referohen programit të eficencës nga memoria afatshkurtër. Nëse të dhënat fshihen në programin e eficencës, atëherë edhe vlerat rivendosen në memorien afatshkurtër.

Në varësi të pajisjes së automjetit, ju keni në dispozicion në programin e eficencës treguesit e mëposhtëm shtesë:

– **Treguesi i zgjeruar i marsheve**: Treguesi i zgjeruar i marsheve ndjek të njëjtën logjikë si treguesi „i rregullt“ i marsheve (treguesi i ndërrimit të marsheve). Nëse shfaqet treguesi i zgjeruar i marsheve, atëherë treguesi „i rregullt“ i marsheve shuhet ⇨ *faqja 23*.
– **Energy consumers** (Konsumatorët e energjisë): Në programin e eficencës listohen konsumatorë shtesë, të cilët ndikojnë në konsumin aktual të karburantit. Monitori tregon deri në tre konsumatorë shtesë. Konsumatori më i madh qëndron në pozicionin më të sipërm. Nëse janë ndezur më shumë se tre konsumatorë, tregohen konsumatorët aktual më të mëdhenj. Përveç kësaj, një shkallë ju informon mbi shumën aktuale të të gjithë konsumatorëve shtesë.
– **Këshilla kursimi**: Në situata të caktuara të konsumit në programin e eficencës shfaqen automatikisht këshilla kursimi afatshkurtër. Nëse mund t'i ndiqni këto këshilla kursimi, ju mund të reduktoni konsumin e karburantit të automjetit tuaj. Për të shuar një këshillë kursimi menjëherë pas shfaqjes, shtypni një buton të preferuar në timonin multifunksional.

Treguesi i ndërrimit të marsheve

Për tu njohur me treguesin e ndërrimit të marsheve, udhëtoni si fillim si çdo herë tjetër. Nëse marshi i vendosur nuk është optimal për një mënyrë të udhëtuari ekonomike, në ekranin e kruskotit shfaqet një këshillë në lidhje me marshin. Nëse nuk jepet një këshillë, ju po udhëtoni tashmë me marshin e duhur.

Automjetet me kambio manuale

– ▶ **Kalimi në marshet e sipërme:** Treguesi shfaqet djathtas nga marshi i vendosur, nëse rekomandohet një marsh më i lartë.
– ◀ **Kalimi në marshet e poshtme:** Treguesi shfaqet majtas nga marshi i vendosur, nëse rekomandohet një marsh më i ulët. ▶

– **N**: Treguesi shfaqet në vend të marshit të vendosur. Kaloni në pozicionin afolio dhe lëshoni pedalin e friksionit. Motori fiket automatikisht.

Automjetet me kambio automatike

Tregimi është i dukshëm vetëm në regjimin tiptronic ⇨ *faqja 88*. Simboli ↑ pas marshit të vendosur do të thotë: **Vendosni një marsh më të lartë**.

KUJDES

Treguesi i ndërrimit të marsheve duhet t'ju ndihmojë juve që të kurseni karburant. Ai nuk është i përshtatshëm që të këshillojë në të gjitha situatat e udhëtimit marshin e duhur. Për situata udhëtimi si p.sh. parakalimi ose udhëtimi në malore, zgjedhja e marshit të duhur mund të kryhet nga drejtuesi i mjetit.

Butona të tjerë funksioni

Vlen për: Timonin multifunksional plus



Fig. 11 Ana e djathtë e timonit multifunksional plus

Ndryshimi i volumit

Volumi i një burimi audio ose i një këshille sistemi (p.sh. në sistemin e komunikimit me zë) mund të konfigurohet direkt gjatë transmetimit.

- ▸ Për ta ngritur/ulur volumin, rrotulloni rulin e djathtë (3) ⇨ *fig. 11* lart/poshtë ose rrotulloheni butonin e volumit ⇨ *faqja 162, fig. 122* djathtas/majtas.
- ▸ Për ta kaluar pa zë, shtypni rulin e djathtë ose butonin e volumit.

Zgjedhja e titullit/kanalit të mëparshëm/tjetër

- ▸ Shtypni butonin |◁◁ / ▷▷| (4) ose shtypni butonin e volumit shkurtimisht majtas/djathtas.

Kalimi para/mbrapa

- ▸ Mbajeni të shtypur butonin |◁◁ / ▷▷| (4) ose shtypni butonin e volumit për aq kohë nga e majta/djathta, derisa të arrihet pozicionin i dëshiruar i transmetimit.

Butoni i timonit për aksesin e shpejtë

Në varësi të statusit të automjetit, me butonin (5) keni akses të shpejtë te funksione të ndryshme.

Butonin ✳ mund ta zini me funksione të ndryshme sipas dëshirës.

- ▸ Për të hapur funksionin e konfiguruar aktualisht, shtypni butonin ✳.
- ▸ Për të pyetur funksionin e konfiguruar aktualisht, mbajeni të shtypur butonin ✳, ose
- ▸ Zgjidhni në sistemin e informimit dhe argëtimit: Butoni MENU > **Car** (Automjeti) > butoni i majtë i komandimit > **Vehicle settings** (Cilësimet e automjetit)> **Steering wheel button** (Alokimi i butonit të timonit).
- ▸ Zgjidhni dhe konfirmoni funksionin e dëshiruar.

Përsëritja e njoftimit me zë të navigimit

- ▸ Në rastin e udhëheqjes aktive për në destinacion shtypni butonin NAV (6).
- ▸ Për të ndryshuar volumin e njoftimit me zë të navigimit, gjatë kohës së njoftimit me zë të navigimit rrotulloni rulin e djathtë (3) sipër/poshtë.

Ndezja/fikja e përdorimit të jashtëm me zë

Butoni (2), shihni ⇨ *faqja 181*.

Përdorimi i funksioneve të telefonit

Butoni (1), shihni ⇨ *faqja 176*.

Hapja dhe mbyllja

Mbyllja qendrore

Të përgjithshme

VINI RE

– Nëse largoheni nga automjeti, fikni kuadrin dhe merreni me vete çelësin. Kjo vlen sidomos, nëse në automjet mbeten fëmijë. Përndryshe fëmijët mund ta ndezin automjetin ose të aktivizojnë pajisjet elektrike (p.sh. ngritësit elektrikë të xhamave) – Rrezik aksidenti!

– Në rastin kur automjeti mbyllet nga jashtë, nuk lejohet që në automjet të mbeten persona, sidomos fëmijë, pasi xhamat nuk mund të hapen më nga brenda. Dyert e mbyllura ja vështirësojnë ndihmësve në rast emergjence që të futen në hapësirë e brendshme të automjetit – Rrezik vdekje!

– Vlen për: Automjetet me alarm kundër vjedhjes: Në rastin kur automjeti mbyllet nga jashtë me Safelock* të aktivizuar, nuk lejohet që në automjet të mbeten persona, sidomos fëmijë, pasi dyert nuk mund të hapen më nga brenda ⇨ *faqja 29, Alarmi kundër vjedhjes*. Dyert e mbyllura ja vështirësojnë ndihmësve në rast emergjence që të futen në hapësirë e brendshme të automjetit – Rrezik vdekje!

– Vlen për: Siguresa e fëmijëve: Kur siguresa e fëmijëve është e ndezur nuk lejohen që në automjet të mbeten persona – sidomos asnjë fëmijë –, pas dyert e pasme dhe xhamat nuk mund të hapen më nga brenda – Rrezik për jetën!

Përshkrimi

Të gjitha dyert dhe dera e bagazhit mund të hapen dhe të mbyllen në mënyrë qendrore në të njëjtën kohë. Nëse gjatë hapjes duhet të hapet i gjithë automjeti ose vetëm dera e drejtuesit të mjetit, mund ta konfiguroni në MMI ⇨ *faqja 26*. Gjatë hapjes sinjalet pulsojnë dy herë, gjatë mbylljes një herë. Nëse gjatë nuk ndizen sinjalet gjatë mbylljes, kontrolloni nëse të gjitha dyert ose kapakët janë të mbyllura.

Në varësi të pajisjes së automjetit, keni mundësi të ndryshme që ta hapni/mbyllni automjetin tuaj në mënyrë qendrore.

– Çelësi i automjetit ⇨ *faqja 31*
– Sensorët te dorezat e përparme të dyerve ⇨ *faqja 31*
– Fisheku i bravës te dera e drejtuesit të mjetit ⇨ *faqja 28*
– Butoni i mbylljes qendrore brenda ⇨ *faqja 27*
– Pajisja celulare (p.sh. Smartphone) ⇨ *faqja 215*

Çelësi / Çelësi i automjetit

Nëse flitet për „çelësin“, atëherë në këtë mënyrë mund të jetë nënkuptuar çelësi me valë ose çelësi i komoditetit* ose një pajisje celulare.

Nëse flitet mbi „çelësin e automjetit“, nënkuptohet çelësi me valë ose komod*. Çelësi komod* është një çelës me valë me funksione të veçanta ⇨ *faqja 31* dhe ⇨ *faqja 82*.

Kyçja automatike

Nëse automjeti hapet dhe brenda një kohe të shkurtër nuk hapet asnjë derë, dera a bagazhit ose kofano e motorit, automjeti mbyllet përsëri në mënyrë automatike. Ky funksion parandalon hapjen e vazhdueshme pa dashje të automjetit.

Mbyllja automatike (Auto Lock)

Funksioni Auto Lock i mbyll dyert dhe derën e bagazhit duke filluar nga një shpejtësi prej rreth 15 km/h. Automjeti hapet përsëri, nëse aktivizohet funksioni i hapjes te çelësi i mbylljes qendrore.

Mund t'i hapni dyert në mënyrë individuale nga brenda, duke tërhequr dorezën e hapjes së derës.

Përveç kësaj në rastin e një aksidenti me aktivizim të jastëkëve të ajrit dyert hapen automatikisht, për t'i mundësuar personave që japin ndihmë aksesin në automjet.

Bllokimi pa dashje

Kyçeni automjetin vetëm nëse të gjitha dyert dhe dera e bagazhit janë mbyllur dhe asnjë çelës nuk gjendet në automjet. Në këtë mënyrë pengoni një bllokim pa dashje. ▶

Në rastet e mëposhtme parandalohet që ta mbyllni çelësin e automjetit tuaj brenda në automjet:

– Kur dera e drejtuesit të mjetit është e hapur, automjeti nuk mund të mbyllet, nëse shtypni butonin në çelësin me valë ose kur prekni sensorin e mbylljes* te një nga dyert e përparme.
– Vlen për: Automjetet me çelësin e komoditetit: Nëse çelësi i përdorur së fundmi i automjetit gjendet në hapësirën e bagazhit, atëherë dera e bagazhit hapet përsëri pas mbylljes ⇨.
– Vlen për: Automjetet me çelësin e komoditetit: Nëse çelësi i përdorur së fundmi dallohet në automjet, automjeti nuk mund të mbyllet nga jashtë ⇨.

VINI RE

Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.

KUJDES

Vlen për: Automjetet me çelës komod

Gjatë mbylljes së automjetit vlen si më poshtë:

– Nëse çelësi i përdorur së fundmi dallohet në automjet, automjeti nuk mund të mbyllet nga jashtë **me sensor**. Merreni me vete çelësin e automjetit dhe mbylleni përsëri automjetin, përndryshe automjeti nuk është i siguruar kundrejt aksesit të paautorizuar.
– Nëse e mbyllni automjetin kur dera e pasagjerit para/dera mbrapa është e hapur **me butonin në çelësin e automjetit**, e vendosni pa dashje çelësin e automjetit në brendësi të automjetit dhe mbyllni derën, në fillim automjeti mbyllet. Por nëse pas kësaj mbyllje në hapësirën e brendshme të automjetit dallohet një çelës automjeti (nëpërmjet sistemit Keyless), automjeti hapet përsëri. Kjo gjë tregohet me pulsim disa herë të sinjaleve. Nëse automjeti nuk hapet brenda një kohe të shkurtër, për të marrë me vete çelësin e automjetit, automjeti mbyllet automatikisht. Në këtë mënyrë pengohet një mbyllje e përhershme pa dashje. Çelësi i automjetit më pas është mbyllur në kabinën e pasagjerëve.
– Nëse dera e bagazhit mbyllet dhe dallohet çelësi i përdorur së fundmi i automjetit në bagazh, dera e bagazhit hapet përsëri. Kjo gjë tregohet me pulsim disa herë të sinjaleve. Dyert janë të mbyllura. Merreni me vete çelësin e automjetit, përndryshe automjeti nuk është i siguruar kundrejt aksesit të paautorizuar.

Udhëzim

– Mos lini kurrë sende me vlerë të pa mbikëqyrura në automjet. Edhe një automjet i mbyllur nuk është kasafortë!
– Nëse e hapni automjetin, pulson LED në parapetin e derës. Nëse LED ndriçon pas mbylljes për rreth 30 sekonda, kemi të bëjmë me një defekt të mbylljes qendrore. Riparojeni defektin te një ndërmarrje e specializuar.

Konfigurimi i mbylljes qendrore

Mund ta përshtatni në mënyrë individuale mbylljen qendrore. Cilësimet varen nga pajisja e automjetit.

▸ Zgjidhni në sistemin e informimit dhe argëtimit: Butoni MENU > **Car** (Automjeti) > butoni i majtë i komandimit > **Vehicle settings** (Cilësimet e automjetit)> **Central locking** (Mbyllja qendrore).

Doors to unlock (Hapja e dyerve)

– Nëse zgjidhni **All** (Të gjitha), gjatë hapjes hapen të gjitha dyert dhe dera e bagazhit.
– Nëse zgjidhni **Driver's door** (Dera e drejtuesit të mjetit), hapet vetëm dera e drejtuesit të mjetit. Për të hapur të gjitha dyert e derës së bagazhit, shtypni dy herë butonin te çelësi i automjetit. Tek automjetet me çelës komod* hapet vetëm dera përkatëse, nëse kapni dorezën e derës.

Nëse shtypni butonin, mbyllet gjithmonë i gjithë automjeti. ▶

Long press to open windows (Shtyp gjatë për të hapur xhamat)

Ju mund të konfiguroni nëse të gjithë xhamat dhe tavani panoramik* mund të hapen me çelësin e automjetit ⇨ *faqja 37, Hapja/mbyllja komode*. Nëse shtypni për një kohë të gjatë butonin te çelësi i automjetit, mbyllen gjithmonë të gjithë xhamat dhe tavani panoramik*.

Fold mirrors (Palos pasqyrat)

Mund të konfiguroni nëse pasqyrat e jashtme palosen automatikisht gjatë mbylljes.

Tone when locking[1] (Melodia gjatë mbylljes)

Mund të konfiguroni nëse gjatë mbylljes së automjetit dëgjohet një sinjal akustik.

Butoni i mbylljes qendrore

Fig. 12 Dera e drejtuesit të mjetit: Butoni i mbylljes qendrore

▸ Për ta mbyllur/hapur automjetin, shtypni butonin / ⇨ .

Nëse automjeti juaj mbyllet me butonin e mbylljes qendrore, vlen si më poshtë:

– Hapja e dyerve dhe e derës së bagazhit nga jashtë nuk është e mundur (Siguri p.sh. kur ndaloni në semafor).
– LED te butoni i mbylljes qendrore ndriçon, nëse të gjitha dyert janë mbyllur dhe kyçur.
– Mund t'i hapni dyert në mënyrë individuale nga brenda, duke tërhequr dorezën e hapjes së derës.
– Në rastin e një aksidenti ku aktivizohet jastëku i ajrit dyert e mbyllura nga brenda hapen automatikisht, për t'i mundësuar hyrjen në automjet të personave që japin ndihmë.

VINI RE

– Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.
– Butoni i mbylljes qendrore funksionon edhe kur kuadri është i fikur.
– Në rastin kur automjeti është i mbyllur nga jashtë, butoni i mbylljes qendrore është jashtë funksioni.

Këshilla udhëtimi

Në varësi të pajisjes së automjetit mund të shfaqen udhëzimet e mëposhtme për drejtuesin e automjetit:

Automatic transmission (Kambio automatike):
Driver's door: fault. Shift to P before leaving vehicle. See owner's manual (Dera e drejtuesit të mjetit: keqfunksionim! Përpara se të zbrisni vendosni marshin P. Shihni librin e bordit)

Kemi të bëjmë me një defekt të derës së drejtuesit të mjetit. Sigurojeni automjetin para se të zbritni, duke vendosur marshin P. Udhëtoni më pas te një ndërmarrje e specializuar dhe riparojeni defektin.

[1] Ky funksion nuk është i disponueshëm tek të gjitha modelet e vendeve.

Hapja/mbyllja e emergjencës e dyerve

Në rastin kur mbyllja qendrore është me defekt, dyert duhet të hapen/mbyllen në mënyrë të veçuar.

Fig. 13 Dera e drejtuesit të mjetit: Fisheku i bravës



Fig. 14 Dera: Mbyllja e emergjencës

Vlen për: Automjete me alarm kundër vjedhjes: Pas hapjes te fisheku i mbylljes dhe hapjes së derës së drejtuesit të mjetit duhet që të shtypni butonin te çelësi i automjetit ose të ndizni kuadrin. Përndryshe aktivizohet alarmi.

Hapja/mbyllja e derës së drejtuesit të mjetit me çelësin e automjetit

- Hapeni çelësin e automjetit ⇨ *faqja 30, fig. 15*.
- Për ta hapur derën e drejtuesit të mjetit, rrotulloheni çelësin në pozicionin e hapjes (1) ⇨ *fig. 13* ⇨ (!).
- Për ta hapur derën e drejtuesit të mjetit, tërhiqni dorezën e derës.
- Kambioja manuale: Për ta mbyllur derën e drejtuesit të mjetit, rrotullojeni çelësin një herë në pozicionin e mbylljes (2) ⇨ ⚠.
- Kambioja automatike: Për ta mbyllur derën e drejtuesit të mjetit, zgjidhni marshin P, mbyllni derën dhe rrotullojeni çelësin një herë në pozicionin e mbylljes (2) ⇨ ⚠.

Mbyllja e dyerve të pasagjerit para/dyerve mbrapa me çelësin e automjetit

Mbyllja e emergjencës gjendet në pjesën ballore të dyerve (1) ose në vrimën e çelësit (2) ⇨ *fig. 14*. Ajo është e dukshme vetëm kur dera është e hapur.

- Hapeni çelësin e automjetit ⇨ *faqja 30, fig. 15*.
- Nëse është e nevojshme nxirreni kapuçin mbulues nga vrima ⇨ *fig. 14*.
- Futeni çelësin e automjetit në vrimën që gjendet në pjesën e brendshme dhe rrotullojeni atë djathtas deri në fund (dera e djathtë) ose majtas (dera e majtë).
- Nëse është e nevojshme mbylleni përsëri vrimën me kapuçin mbyllës dhe mbyllni derën.

Pas mbylljes së dyerve të pasagjerëve para/pasme, hapja nga jashtë nuk është më e mundur. Dera mund të hapet nga brenda duke tërhequr një herë dorezën e hapjes së derës. Nëse te një nga dyert e pasagjerëve mbrapa është ndezur siguresa e fëmijëve, duhet që si fillim të tërhiqni dorezën e hapjes së derës nga brenda. Më pas mund ta hapni derën nga jashtë.

⚠ VINI RE

Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.

(!) KUJDES

Për të mos e dëmtuar çelësin dhe fishekun e bravës, futni çelësin vetëm në drejtimin e treguar në fishekun e bravës ⇨ *fig. 13*. Tek ▶

automjetet me timon djathtas çelësi duhet futur përkatësisht ndryshe.

Alarmi kundër vjedhjes

Vlen për: Automjete me alarm kundër vjedhjes

Nëse alarmi kundër vjedhjes dallon futjen në automjet, aktivizohen sinjale paralajmëruese akustike dhe optike. Alarmi kundër vjedhjes aktivizohet ose çaktivizohet automatikisht gjatë mbylljes/hapjes së automjetit tuaj. Një alarm i aktivizuar fiket automatikisht pas një kohe të caktuar.

Fikja manuale e alarmit

▸ Për ta fikur alarmin, shtypni butonin te çelësi me valë ose ndizni kuadrin.

Në varësi të pajisjes së automjetit, alarmi kundër vjedhjes mund të ketë pjesët përbërëse të mëposhtme:

Sistemi i mbrojtjes kundrejt hyrjes me forcë

Alarmi aktivizohet gjatë hapjes me forcë të dyerve, kofanos dhe derës së bagazhit dhe gjatë hapjes së një dere, nëse më parë hapja u krye nëpërmjet fishekut të bravës.

Monitorimi i hapësirës së brendshme/ mbrojtjes kundrejt rimorkimit

Alarmi aktivizohet gjatë lëvizjeve në hapësirën e brendshme (p.sh. të kafshëve) ose gjatë një ndryshimi të pjerrësisë së automjetit (p.sh. gjatë transportit të automjetit).

Ju e mënjanoni alarmin e padëshiruar, duke çaktivizuar monitorimin e hapësirës së brendshme/mbrojtjes kundrejt rimorkimit.

Safelock[1)]

Automjeti nuk mund të hapet më nga brenda. Në këtë mënyrë vështirësohen mundësitë e hapjes me forcë ⇨ ⚠. Si kujtesë për Safelock* pas fikjes së kuadrit në ekranin e kruskotit shfaqet udhëzimi për drejtuesin e mjetit **Be aware of door safelock** (Kushtojini vëmendje Safelock) **Handbook** (Shihni librin e bordit).

Nëse lini persona në automjet, duhet që të çaktivizoni Safelock.

Çaktivizimi i monitorimit të hapësirës së brendshme/mbrojtjes kundrejt rimorkimit dhe Safelock[1)]

Për ta çaktivizuar monitorimin e hapësirës së brendshme/mbrojtjes kundrejt rimorkimit dhe Safelock*, keni mundësitë e mëposhtme:

▸ Shtypni butonin te çelësi i automjetit **brenda 2 sekondave** një herë tjetër. Ose
▸ Vlen për: Automjetet me çelës komod: Prekeni për një herë të dytë sensorin në dorezën e derës së dyerve të përparme **brenda 2 sekondave**. Ose
▸ Rrotulloheni çelësin e automjetit në bravën e derës **brenda 2 sekondave** për një herë të dytë në pozicionin e mbylljes.

Nëse e mbyllni automjetin tuaj në këtë mënyrë, monitorimi i hapësirës së brendshme/mbrojtjes kundrejt rimorkimit dhe Safelock* është i fikur deri në hapjen tjetër.

Në rastin e çaktivizimit të suksesshëm LED pulson shkurtimisht në panelin e derës dhe më pas qëndron e fikur për rreth një gjysmë minute.

⚠ VINI RE

Në rastin kur automjeti është mbyllur nga jashtë me Safelock* të aktivizuar nuk lejohen që në automjet të mbeten persona – sidomos fëmijë, pasi dyert dhe xhamat nuk mund të hapen më nga brenda. Dyert e mbyllura ja vështirësojnë ndihmësve në rast emergjence që të futen në hapësirë e brendshme të automjetit – Rrezik vdekje!

! KUJDES

– Nëse e fikni Safelock*, monitorimi i hapësirës së brendshme/mbrojtjes kundrejt rimorkimit fiket automatikisht. Kjo gjë vlen edhe anasjelltas. Automjeti juaj nuk është i mbrojtur plotësisht kundrejt hyrjes me forcë dhe vjedhjes. ▸

[1)] Ky funksion nuk është opsional ose nuk është i disponueshëm tek të gjitha modelet e vendeve/pajisjet.

– Vlen për: Automjetet me sistem kontrolli automjeti Audi connect: Gjatë mbylljes së automjetit në distancë nëpërmjet shërbimeve Audi connect, Safelock nuk ndizet.

Udhëzim

– Monitorimi i hapësirës së brendshme/mbrojtjes kundrejt rimorkimit funksionon vetëm atëherë siç duhet, nëse xhamat dhe tavani* janë mbyllur.
– Nëse tërhiqni një dorezë për hapjen e derës në brendësi të automjetit aktivizohet alarmi, edhe nëse e keni fikur Safelock*.

Çelësi

Kompleti i çelësave



Fig. 15 Kompleti i çelësit të automjetit tuaj

Kompleti i çelësave nga fabrika përbëhet nga dy çelësa automjeti.

① Çelësi i automjetit

Me çelësin e automjetit mund të hapni dhe mbyllni automjetin tuaj. Për të hapur majën e çelësit, shtypni butonin e hapjes ⇨ *fig. 15*.

Me çelësin e automjetit në rast nevoje mund të

– fikni/ndizni jastëkun e ajrit të pasagjerit para * ⇨ *faqja 60*.
– Vlen për automjetet me sirtar kruskoti që mund të mbyllet: mbyllja/hapja e çelësit të kruskotit.
– të kryeni hapjen/mbylljen e emergjencës së dyerve ⇨ *faqja 28*.
– të kryeni mbylljen e emergjencës së derës së bagazhit ⇨ *faqja 35*.

Humbja/zëvendësimi i një çelësi

Në rastin e humbjes së çelësit të automjetit drejtojuni një servisi Audi. Bllokojeni funksionimin e këtij çelësi të automjetit. Për këtë gjë është e domosdoshme që të sillni me vete të gjithë çelësat. Humbjen e një çelësi duhet t'ia raportoni siguracionit tuaj.

Vlen për: Komandimi i automjetit Audi connect: Në rastin e humbjes së një pajisje celulare me komandimin aktiv të automjetit Audi connect (mbyllja/hapja me telekomandë) duhet që pajisja përkatëse celulare të çaktivizohet ⇨ *faqja 215*.

Imobilizatori elektronik

Imobilizatori parandalon vënien a paautorizuar në punë të automjetit.

Sistemi i lëvizjes së mjetit nuk mund të kryhet në rrethana të caktuara, nëse një çelës automjeti i një prodhuesi tjetër automjetesh gjendet në tufën e çelësave.

Të dhënat në çelësin e automjetit

Gjatë udhëtimit në çelësin e automjetit tuaj ruhen vazhdimisht të dhëna të rëndësishme për servisin dhe mirëmbajtjen. Servisi juaj Audi mund t'i lexojë këto të dhëna dhe t'ju informojë mbi punimet e domosdoshme në automjetin tuaj.

VINI RE

Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.

KUJDES

Mbrojeni çelësin kundrejt temperaturave të larta dhe rrezatimit të drejtpërdrejtë të diellit.

Udhëzim për ambientin

Bateritë dhe pajisjet elektrike/elektronike duhet të hidhen në përputhje me rregullat për mbrojtjen e mjedisit ⇨ *faqja 352, Këshilla për hedhjen*.

Udhëzim

– Funksioni i çelësit të automjetit mund të ndikohet nga ana e mbivendosjes së ▶

kanaleve që gjenden në afërsi të automjetit, të cilët punojnë në të njëjtin brez frekuencash (p.sh. telefon celular, kanal televiziv). Kontrolloni gjithmonë nëse automjeti juaj është i mbyllur!

– Ju mund të shfaqni numrin e çelësave të automjetit të mësuar: Zgjidhni në sistemin e informimit dhe argëtimit: Butoni **MENU** (MENY) > **CAR** (Automjet) > butoni i majtë i komandimit > **Servicing & checks** (Servis dhe kontroll)> **Car information** (Informacione mbi automjetin).
– Kompleti i çelësave mund të jetë i lidhur që në fabrikë me një varëse çelësash, që përmban informacione mbi kompletin e çelësave të automjetit. Varësja e çelësave mund të përdoret për porositjen e mëvonshme të çelësave të automjetit. Ruajeni varësen e çelësave ose dorëzojani atë blerësit në rastin kur e shitni automjetin.

Hapja/mbyllja e automjetit

Vlen për: Automjetet me çelës komod
Fig. 16 Doreza e derës: Sensori* për mbylljen

Në varësi të pajisjes së automjetit, keni mundësi të ndryshme që ta hapni/mbyllni automjetin. Se cilat dyer do të hapen varet nga cilësimet në ekranin e sistemit të informimit dhe argëtimit ⇨ *faqja 26*.

Hapja/mbyllja me butonat në çelësin e automjetit

▸ Për ta hapur automjetin, shtypni butonin ⇨ *faqja 30, fig. 15*.

▸ Për ta mbyllur automjetin, shtypni **një herë** butonin.

Hapja/mbyllja me sensorë

Vlen për: Automjetet me çelës komod

▸ Për t'i hapur dyert/derën e bagazhit, kapni dorezën përkatëse të derës së përparme/dorezën e derës së bagazhit.
▸ Për ta mbyllur automjetin, mbylleni derën dhe prekni **një herë** sensorin në dorezën e derës së përparme ⇨ *fig. 16*. Në këtë rast mos e kapni dorezën e derës, përndryshe automjeti nuk mbyllet. Rihapja e derës direkt pas procesit të mbylljes nuk është e mundur për një kohë të shkurtër. Në këtë mënyrë keni mundësinë të siguroheni për mbylljen e duhur të dyerve.

Çaktivizimi për hapjen e sensorëve

Vlen për: Automjetet me çelës komod

Ju mund ta çaktivizoni hapjen me çelësin komod (hyrja pa çelës) për një cikël të mbylljes/hapjes.

▸ Kambio automatike: Çoni levën e marshit në pozicionin P, meqë automjeti ndryshe nuk mund të mbyllet.
▸ Mbyllni derën.
▸ Shtypni butonin e mbylljes te çelësi komod dhe prekni një herë brenda 5 sekondave sensorin te doreza e derës (dera e drejtuesit të mjetit) ⇨ *fig. 16*. Në këtë rast mos e kapni dorezën e derës, përndryshe automjeti nuk mbyllet.
▸ Për të kontrolluar nëse funksioni u çaktivizua, prisni të paktën 10 sekonda dhe më pas tërhiqni edhe njëherë dorezën e derës. Dera nuk duhet të hapet.

Gjatë hapjes së radhës automjeti mund të hapet vetëm me valë ose në fishekun e bravës. Pas mbylljes/hapjes së radhës aksesi pa çelës është përsëri aktiv.

Hapja/mbyllja me shërbimin e kontrollit të automjetit Audi connect[1)]

Vlen për: Automjete me sistem kontrolli automjeti Audi connect

Kusht: Shërbimet e kontrollit të automjetit Audi connect janë krijuar ⇨ *faqja 215, Audi connect* ▶

[1)] Në varësi të vendit

Shërbimet e komandimit të automjetit. Automjeti nuk është në lëvizje dhe kuadri është fikur.

Kushtojini vëmendje informacioneve në lidhje me „Safelock“ ⇨ ⓘ *në Alarmi kundër vjedhjes në faqen 29*.

VINI RE

Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.

Udhëzim

– Përdoreni çelësin e automjetit vetëm kur keni kontakt vizual me automjetin.
– Kambio automatike: Automjeti mund të mbyllet vetëm kur leva e marsheve gjendet në pozicionin P.
– Mos e kryeni hapjen/mbylljen me çelësin e automjetit nëse gjendeni në automjet. Përndryshe mund të aktivizoni alarmin e vjedhjes*. Shtypni në këtë rast butonin e hapjes.

Udhëzim

Vlen për: Automjetet me çelës komod

– Gjatë hapjes/mbylljes së automjetit çelësi komod nuk lejohet që të jetë më larg se rreth 1,5 m nga doreza e derës ose nga bagazhi.
– Hapja me çelësin komod (aksesi pa çelës) mund të çaktivizohet ⇨ *faqja 31*.
– Për të mënjanuar një shkarkim të baterisë së automjetit, sistemi i menaxhimit të energjisë fik njëri pas tjetrit funksionet e panevojshme komode. Mund të ndodhë që më pas të mund të mos e hapni më automjetin tuaj me sensor.

LED dhe bateria në çelësin me valë



Fig. 17 Çelësi me valë (ana e pasme): Hapja e kapakut

LED në çelësin me valë

LED në çelësin me valë (ana e përparme) ju informon mbi funksionimin e çelësit me valë.

- Nëse e shtypni shkurtimisht një buton, LED pulson një herë.
- Nëse e shtypni për një kohë të gjatë një buton (hapja/mbyllja komode), LED pulson disa herë.
- Nëse LED nuk pulson, bateria e çelësit të automjetit është e shkarkuar. Ndërrojeni baterinë në çelësin e automjetit.

Zëvendësimi i baterisë së çelësit me valë

Bateria rezervë në çelësin me valë duhet të jetë në përputhje me specifikimet e baterisë origjinale (tipi i baterisë **CR 2032**).

- Ngrini kapakun ② me një monedhë nga pjesa e çelësit ① ⇨ *fig. 17*.
- Futeni baterinë e re me shenjën „+“ nga sipër.
- Shtypni kapakun përsëri në çelës derisa ai të fiksohet.

Nëse drita e kontrollit shfaqet me një këshillë përkatëse udhëtimit, bateria e çelësit të automjetit është e shkarkuar dhe duhet të ndërrohet.

VINI RE

Nëse gëlltiten bateritë/pilat në formën e kopsës ose futen në trup në rrugë të tjera, në një kohë shumë të shkurtër pasojat mund të jenë lëndime të rënda ose madje vdekjeprurëse - Rrezik djegiesh kimike ose djegieje!
– Ruajeni çelësin e automjetit si dhe varësen e çelësave me bateri larg nga fëmijët.

– Mbajini bateritë e reja ose të konsumuara larg nga fëmijët.
– Nëse foleja e baterisë nuk mbyllet në mënyrë të sigurt, mos e përdorni më tej çelësin e automjetit dhe mbajeni atë larg nga fëmijët.
– Merrni menjëherë ndihmë nga mjeku, nëse dyshohet që është gëlltitur një bateri ose ka hyrë në trup nëpërmjet një rruge tjetër.

Udhëzim për ambientin

Bateritë dhe pajisjet elektrike/elektronike duhet të hidhen në përputhje me rregullat për mbrojtjen e mjedisit ⇨ *faqja 352, Këshilla për hedhjen*.

Sinkronizimi i çelësit me valë

Çelësi me valë duhet sinkronizuar, nëse automjeti nuk mund të hapet/mbyllet me valë.

▸ Shtypni butonin e çelësit me valë.
▸ Mbyllni me çelës brenda 30 sekondave fishekun e bravës në derën e drejtuesit të mjetit ⇨ *faqja 28*.
▸ Shtypni butonin ose butonin .

Dera e bagazhit

Të përgjithshme

VINI RE

– Në rastin kur automjeti mbyllet nga jashtë, nuk lejohet që në automjet të mbeten persona, sidomos fëmijë, pasi xhamat nuk mund të hapen më nga brenda. Dyert e mbyllura ja vështirësojnë ndihmësve në rast emergjence që të futen në hapësirë e brendshme të automjetit – Rrezik vdekje!
– Vlen për: Automjetet me alarm kundër vjedhjes: Në rastin kur automjeti mbyllet nga jashtë me Safelock* të aktivizuar, nuk lejohet që në automjet të mbeten persona, sidomos fëmijë, pasi dyert nuk mund të hapen më nga brenda ⇨ *faqja 29, Alarmi kundër vjedhjes*. Dyert e mbyllura ja vështirësojnë ndihmësve në rast emergjence që të futen në hapësirë e brendshme të automjetit – Rrezik vdekje!
– Mbyllini dhe kyçini gjithmonë derën e bagazhit dhe dyert, nëse nuk e përdorni automjetin. Përndryshe një fëmijë mund të futet p.sh. nëpërmjet bagazhit në automjet dhe të mbyllet atje. Mos i lini kurrë fëmijët që të luajnë në ose përreth automjetit, për të mënjanuar lëndime.
– Sigurohuni që gjatë mbylljes të mos gjendet askush në zonën e funksionimit të derës së bagazhit, sidomos në zonën e menteshave, të tehut të sipërm dhe të poshtëm, si dhe në përgjithësi përreth cepit - Rrezik lëndimesh për shkak të shtypjes!
– Sigurohuni që pas mbylljes së derës së bagazhit që mekanizmi i mbylljes të jetë fiksuar. Dera e bagazhit mund të hapet papritur gjatë udhëtimit – Rrezik aksidenti!
– Mos udhëtoni kurrë me derë bagazhi të mbështetur ose madje të hapur, pasi përndryshe gaze nga mjedisi përreth mund të futen në hapësirën e brendshme – Rrezik helmimi!
– Nëse gjendet një mbajtës bagazhesh i montuar p.sh. një mbajtës biçikletash te dera e bagazhit, në rrethana të caktuara dera e bagazhit nuk mund të hapet plotësisht, ose një dera e hapur e bagazhit të mbyllet vetëm për shkak të peshës së shtuar. Prandaj duhet që dera e hapur e bagazhit të ketë një mbështetje shtesë ose më parë ngarkesa të hiqet nga mbajtësi i bagazheve – Rrezik lëndimi!
– Vlen për: Automjete me derë bagazhi që aktivizohet automatikisht ose me komandim me sensor: Mos e mbyllni kurrë pa vëmendje ose në mënyrë jo të kontrolluar derën e bagazhit. Në këtë mënyrë, me gjithë kufizimin e forcës mund të lëndoni veten ose persona të tjerë!

KUJDES

Dera e bagazhit gjatë hapjes mund të përplaset me tavanin e garazhit dhe mund të dëmtohet. ▸

Udhëzim

Kur automjeti është i mbyllur dera e bagazhit mund të hapet e veçuar, duke shtypur butonin ⇦ në çelësin e automjetit. Nëse e mbyllni përsëri kapakun e bagazhit, ajo kyçet automatikisht.

Hapja/mbyllja e derës së bagazhit

Fig. 18 Dera e bagazhit: Doreza

Fig. 19 Dera e drejtuesit të mjetit: Hapja e derës së bagazhit

Hapja e derës së bagazhit

- Vlen për: Automjete pa çelës komod: Hapeni automjetin ose derën e bagazhit me butonin ⇦ / ⇦ te çelësi i automjetit dhe shtypni dorezën në derën e bagazhit ⇨ *fig. 18*. Ose
- Vlen për: Automjetet me çelës komod: Shtypeni dorezën në derën e bagazhit ⇨ *fig. 18*. Në rastin kur dera e bagazhit është e mbyllur, çelësi i automjetit nuk lejohet që të jetë më larg se 1,5 m nga bagazhi. Ose
- Vlen për: Automjetet me derë bagazhi që aktivizohet automatikisht: Tërhiqeni butonin ⇦ te dera e drejtuesit të mjetit.

Mbyllja e derës së bagazhit

- Vlen për: Automjetet pa derë bagazhi që aktivizohet automatikisht: Tërhiqeni poshtë derën e bagazhit në parvazin e kapjes që gjendet në pjesën e brendshme dhe lëreni atë të bjerë mbi mekanizmin e mbylljes me një vrull të lehtë. Ose
- Vlen për: Automjetet me derë bagazhi që aktivizohet automatikisht: Kushtoni vëmendje ⇨ *faqja 34*.

VINI RE

Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 33*.

Dera e bagazhit që aktivizohet automatikisht

Vlen për: Automjetet me derë bagazhi që aktivizohet automatikisht



Fig. 20 Dera e bagazhit: ① Butoni i mbylljes*, ② Butoni i kyçjes* (Automjetet me çelës komod*)

Dera e bagazhit mund të hapet dhe mbyllet automatikisht ⇨ ⚠ *në Të përgjithshme në faqen 33*.

Hapja e derës së bagazhit

- Shtypni të paktën për një sekondë kur kuadri është i fikur butonin ⇦ te çelësi i automjetit ⇨ *faqja 30, fig. 15*. Ose
- Tërhiqeni shkurtimisht butonin ⇦ në derën e drejtuesit të mjetit. Ose
- Vlen për: Automjetet me çelës komod: Shtypeni dorezën në derën e bagazhit ⇨ *faqja 34, fig. 18*. Në rastin kur dera e bagazhit është e mbyllur, çelësi i automjetit nuk lejohet që të jetë më larg se 1,5 m nga bagazhi. ▶

Mbyllja e derës së bagazhit

- Shtypeni butonin te dera e drejtuesit të mjetit. Ose
- Shtypni dorezën në derën e bagazhit ⇨ *faqja 34, fig. 18*. Ose
- Shtypeni pak poshtë derën e bagazhit. Ose
- Tërhiqeni butonin te dera e drejtuesit të mjetit kur kuadri është i ndezur ⇨ *faqja 34, fig. 19* për aq kohë, derisa dera e bagazhit të mbyllet. Ose
- Vlen për: Automjetet me çelës komod: Kur kuadri është i fikur shtypni butonin te çelësi i automjetit për aq kohë, derisa dera e bagazhit të mbyllet. Gjatë kryerjes së këtij procesi vendosuni në një distancë të mjaftueshme (maksimumi 1,5 m) pas derës së bagazhit. Ose
- Shtypeni butonin te dera e drejtuesit të mjetit. Ose
- Vlen për: Automjetet me çelës komod: Shtypni kur kuadri është i fikur butonin / në derën e bagazhit. Çelësi i automjetit nuk lejohet që të jetë më larg se 1,5 m nga bagazhi dhe nuk lejohet të jetë në automjet. Nëse shtypni butonin *, automjeti më pas është i mbyllur.

Ndalimi i lëvizjes automatike

Lëvizja automatike e derës së bagazhit ndalohet, nëse

- Shtypni përsëri butonin ose dorezën në derën e bagazhit ⇨ *faqja 34, fig. 18*. Ose
- Shtypni te çelësi komod* butonin . Ose
- Lëvizja me vështirësi ose një pengesë e bllokojnë procesin.

Nëse ju e prekni përsëri butonin ose dorezën në derën e bagazhit ⇨ *faqja 34, fig. 18*, dera e bagazhit hapet/mbyllet përsëri.

Ruajtja e pozicionit të hapjes së derës së bagazhit

Pozicioni ruhet duke filluar nga një lartësi e caktuar.

- Çojeni derën e bagazhit në pozicionin e dëshiruar të hapjes. Nëse e çoni poshtë derën e bagazhit, lëvizeni atë me ngadalë me hapa të vegjël, përndryshe dera e bagazhit do të mbyllej automatikisht.
- Shtypni butonin në derën e bagazhit të paktën katër sekonda, për të ruajtur pozicionin e dëshiruar të hapjes. Do të jepet një sinjal optik dhe akustik.
- Për të caktuar një pozicion më të lartë hapjeje, prisni pesë sekonda dhe shtyjeni lart me kujdes derën e bagazhit.
- Shtypni përsëri butonin për të paktën katër sekonda, për të ruajtur pozicionin e dëshiruar të hapjes.

Hapja/mbyllja e emergjencës e derës së bagazhit

Nëse sistemi elektrik i lëvizjes dështon ose në rastin kur bateria e automjetit është e dobët, dera e bagazhit mund të hapet/mbyllet manualisht. Në këtë rast nevojitet një forcë më e madhe. Lëvizeni derën me ngadalë, në këtë mënyrë forca që duhet të ushtrohet është më e vogël.

- Tërhiqeni poshtë derën e bagazhit te doreza që ndodhet nga brenda dhe shtyjeni më pas derën e bagazhit deri sa ajo të mbyllet.

VINI RE

Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 33*.

Hapja e emergjencës së derë së bagazhit

Dera e bagazhit mund të hapet në mënyrë emergjente nga brenda.

Fig. 21 Ndarja e hapësirës së bagazhit: Aksesi për hapjen e emergjencës

- Paloseni para mbështetësen e sediljeve të pasme ⇨ *faqja 70*.
- Hapeni çelësin e automjetit ⇨ *faqja 30, fig. 15*.
- Nxirrni me çelësin e automjetit kapakun ①. ▶

81B012790AG

- ▸ Për ta hapur derën e bagazhit, shtypni dorëzën me çelësin e automjetit në drejtimin e shigjetës (2).
- ▸ Kthejeni në pozicionin fillestar mbështetësen e shpinës derisa ajo të fiksohet.

VINI RE

Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 33*.

VINI RE

Nëse e keni palosur mbrapa mbështetësen e sediljeve të pasme, kontrolloni gjithmonë duke e tërhequr para mbështetësen e sediljes së pasme, nëse fiksimi është kryer siç duhet.

Siguresa e fëmijëve

Siguresa e fëmijëve pengon hapjen e dyerve të pasme nga brenda si dhe përdorimin e ngritësve të xhamave mbrapa.

Fig. 22 Dera e drejtuesit të mjetit: Elementët e kontrollit

Fig. 23 Dera mbrapa: siguresa manuale e fëmijëve

Automjetet me buton

Vlen për: Automjetet me sigurisë elektrike për fëmijët

- ▸ Për ta aktivizuar/çaktivizuar siguresën e fëmijëve (dorezën e hapjes së derës brenda dhe çelësin e ngritësve të xhamave) për derën e pasme përkatëse, shtypni butonin e majtë ose të djathtë në derën e drejtuesit të mjetit (1) ⇨ *fig. 22*. LED në buton ndriçon/fiket.
- ▸ Sigurohuni që siguresa e fëmijëve të jetë efektive, duke kontrolluar që çelësi i ngritësve të xhamave dhe doreza e hapjes së derës mbrapa të mos funksionojnë.

Automjetet me buton

Vlen për: Automjetet me sigurisë manuale për fëmijët

- ▸ Për të aktivizuar/çaktivizuar siguresën për fëmijët te dyert e pasme, shtypni butonin në derën e drejtuesit të mjetit (2) ⇨ *fig. 22*. LED në buton ndriçon/fiket.
- ▸ Për të aktivizuar/çaktivizuar siguresën manuale për fëmijët të dorezës së pasme të hapjes së derës, hapni derën përkatëse dhe rrotulloheni butonin me çelësin e automjetit në drejtimin e shigjetës/drejtimin e kundër të shigjetës ⇨ *fig. 23*. Gjatë këtij procesi nxirret jashtë funksioni doreza përkatëse hapjes së derës së pasme.
- ▸ Sigurohuni që siguresa e fëmijëve të jetë efektive, duke kontrolluar që çelësi i ngritësve të xhamave dhe doreza e hapjes së derës mbrapa të mos funksionojnë.

Nëse është ndezur siguresa e fëmijëve, janë fikur funksionet e mëposhtme:

– Dorezat e pasme të brendshme për hapjen e dyerve
– Ngritësit e pasmë të xhamave

Këshillë për drejtuesin e mjetit në ekranin e kruskotit

Në varësi të pajisjes së automjetit mund të shfaqen udhëzimet e mëposhtme për drejtuesin e automjetit:

Child lock: fault. Please contact workshop (Siguresa e fëmijëve: Defekt! Ju lutemi shkoni te një servis)

Kemi të bëjmë me një defekt të siguresës së fëmijëve. Shtypni përsëri butonin / .

Nëse do të shfaqet përsëri këshilla për drejtuesin e mjetit, udhëtoni së shpejti te një ndërmarrje e specializuar dhe riparojeni defektin. ▶

VINI RE

– Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.
– Në rast defekti të siguresës së fëmijëve dyert e pasme mund të hapen eventualisht nga brenda – Rrezik aksidenti!

Ngritësit elektrikë të xhamave

Hapja/mbyllja e xhamave



Fig. 24 Dera e drejtuesit të mjetit: Çelësi për ngritësit e xhamave

Çelësi për ngritësin e xhamave:

1. Dera e majtë e përparme
2. Dera e djathtë e përparme
3. Dera e majtë e pasme
4. Dera e djathtë e pasme

Hapja/mbyllja e xhamave

Drejtuesi i mjetit mund t'i komandojë të gjithë ngritësit e xhamave. Të gjithë çelësat e ngritësve të xhamave janë pajisur me një funksion me dy shkallë:

- Për ta hapur/mbyllur automatikisht dritaren, shtypni/tërhiqni shkurtimisht çelësin deri në shkallën e dytë. Duke e shtypur edhe njëherë çelësin ndalohet lëvizja.
- Për të konfiguruar një pozicion të ndërmjetëm, shtypeni/tërhiqeni çelësin në shkallën e parë derisa xhami të ketë arritur pozicionin e dëshiruar.

Riparimi i defektit në sistemin automatik të ngritjes/uljes

Nëse sistemi automatik i ngritjes/uljes ka dështuar, ndoshta mund ta aktivizoni përsëri.

- Tërhiqeni çelësin e ngritësit të xhamave derisa xhami të jetë ngritur plotësisht.
- Lëshojeni çelësin dhe tërhiqeni atë përsëri për të paktën një sekondë.

VINI RE

– Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.
– Mos i mbyllni kurrë pa vëmendje ose në mënyrë të pakontrolluar xhamat – Rrezik lëndimi!

Udhëzim

– Pasi ta keni fikur kuadrin, mund t'i hapni dhe mbyllni ende xhamat për disa minuta. Vetëm nëse është hapur dera e drejtuesit të mjetit ose e pasagjerit, butonat e ngritësve të xhamave janë të fikur.
– Ngritësit e xhamave janë pajisur me një sistem mbrojtës kundrejt shtypjes. Mund të ndodhë që lëvizja automatike sipër të ndërpritet dhe xhami të hapet përsëri edhe nëse nuk dallohet një pengesë. Tërhiqeni çelësin e ngritësit të xhamave derisa xhami të jetë ngritur plotësisht.

Hapja/mbyllja komode

Vlen për: Automjetet me çelës komod

Hapja/mbyllja komode e xhamaveTavanit*

Nëse duhet të hapen në të njëjtën kohë të gjithë xhamat ose tavani*, mund ta konfiguroni në MMI ⇨ *faqja 26, Konfigurimi i mbylljes qendrore*.

- Shtypni butonin / te çelësi i automjetit për aq kohë, derisa të gjithë xhamat dhe tavani* të kenë arritur pozicionin e dëshiruar ⇨ . Ose:
- Prekni sensorin* në dorezën e derës ⇨ *faqja 31, fig. 16* për aq kohë, derisa të gjitha xhamat dhe tavani* të jenë të mbyllura. Gjatë kryerjes së këtij procesi mos e vendosni dorën në dorezën e derës. ▶

Nëse janë të mbyllura të gjitha xhamat dhe tavani*, sinjalet pulsojnë një herë.

VINI RE

– Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.
– Mos i mbyllni kurrë pa vëmendje dhe në mënyrë jo të kontrolluar xhamat dhe tavanin* – Rrezik lëndimi!
– Për arsye sigurie duhet që hapja dhe mbyllja e xhamave dhe e tavanit* të kryhet me çelësin e automjetit vetëm nga një distancë prej rreth 2 m. Gjatë shtypjes së butonit duhet që ngritja e xhamave dhe mbyllja e tavanit* të vëzhgohet gjithmonë, në mënyrë që të mos shtypet askush. Nëse lëshohet butoni procesi i mbylljes ndërpritet menjëherë.

Tavani panoramik

Përdorimi i tavani, i grilës së tavanit

Vlen për: Automjetet me tavan panoramik prej xhami



Fig. 25 Tavani panoramik: Butoni për tavanin panoramik prej xhami

Butoni i përdorimit është i pajisur me një funksion me dy shkallë.

Përdorimi i grilës së tavanit

Grila e tavanit mund të hapet dhe mbyllet me dorë, pavarësisht nga pozicioni i hapjes së tavanit panoramik prej xhami. Grila e tavanit mund të vendoset në pozicionet e preferuara të ndërmjetme.

Përdorimi i grilës

- Ngritja e tavanit: Shtypni shkurtimisht butonin në tavanin panoramik deri në shkallën e dytë sipër (1).
- Ulja e tavanit të ngritur: Tërhiqeni shkurtimisht butonin deri në shkallën e dytë poshtë.
- Ngritja e tavanit duke e shtyrë: Shtyjeni shkurtimisht butonin deri në shkallën e dytë mbrapa (2).
- Mbyllja e tavanit të ngritur: Shtyjeni shkurtimisht butonin deri në shkallën e dytë para.
- Konfigurimi i pozicionit të ndërmjetëm: Shtyjeni, shtypeni ose tërhiqeni butonin për aq kohë deri në shkallën e parë, derisa tavani të arrijë pozicionin e dëshiruar.

Mbyllja e emergjencës e tavanit

Nëse gjatë procesit të mbylljes p.sh. dallohet një objekt që ka ngecur, tavani hapet përsëri automatikisht. Në këtë rast ju më pas mund të kryeni mbylljen elektrike të emergjencës.

- Tërhiqeni brenda pesë sekondave pas hapjes automatike butoni përkatës për aq kohë, derisa tavani të jetë mbyllur.

VINI RE

– Kushtojuni vëmendje këshillave të sigurisë ⇨ *faqja 25*.
– Mos i mbyllni kurrë pa vëmendje dhe në mënyrë jo të kontrolluar tavanin – Rrezik lëndimi! Prandaj kur largoheni nga automjeti fikeni gjithmonë kuadrin dhe merreni gjithmonë me vete çelësin.

KUJDES

Mbylleni gjithmonë tavanin kur largoheni nga automjeti juaj dhe kur bie shi, për të mënjanuar dëmtime të pajisjeve të brendshme, sidomos të pajisjeve elektronike.

Udhëzim

– Pas fikjes së kuadrit, tavani mund të përdoren ende për disa minuta, për sa kohë nuk hapet asnjë nga dyert e përparme.
– Hapja e tavanit nuk është e mundur në temperatura shumë të ftohta.

Drita dhe shikimi

Ndriçimi i jashtëm

Ndezja/fikja e dritave

Fig. 26 Kruskoti: Çelësi i dritave me butona

Çelësi i dritave

Rrotulloheni çelësin e dritave kur kuadri është i ndezur në pozicionin përkatës. Ndriçon dhe pozicioni i zgjedhur (përveç se në pozicionin 0).

0 – Në disa modele vendesh të caktuara ndizen vazhdimisht dritat e udhëtimit ditën*, dritat e pasme dhe dritat e targave.

AUTO – Dritat e udhëtimit i përshtatet në mënyrë automatike ndriçimit të mjedisit.

– Drita e parkimit

– Drita e zbehur

Butonat

Nëse e rrotulloni çelësin e dritave në pozicionin AUTO ose dritat e shkurtra , mund të aktivizoni si më poshtë:

– Dritat për të gjitha llojet e motit*. Ndriçimi përpara rregullohet automatikisht në mënyrë që p.sh. në rastin e korsisë së lagur nga shiu drejtuesi i mjetit të mos verbohet nga drita e tij.

– Drita/t e pasme e/të mjegullës

Rregullimi automatik i distancës së ndriçimit

Automjeti juaj është pajisur me një rregullim automatik të distancës së ndriçimit. Ai pengon që kur automjeti është i ngarkuar të mos verbohet trafiku përballë. Distanca e ndriçimit konfigurohet automatikisht.

Audi adaptive light

Vlen për: Automjet me Audi adaptive light

Me adaptive light keni një pamje më të mirë gjatë errësirës, duke e përshtatur dritën në rrethanat e rrugës në varësi të shpejtësisë, si p.sh. autostradat, rrugët interurbane, kryqëzimet, kthesat. Adaptive light funksionon vetëm në pozicionin AUTO të çelësit të dritave dhe kur dritat për të gjitha llojet e motit* janë fikur.

VINI RE

– Drita automatike e udhëtimit ka vetëm një funksion mbështetës. Ajo nuk ja heq drejtuesit të mjetit përgjegjësinë e tij për të kontrolluar dritën e udhëtimit dhe që ta ndezë atë në përputhje me kushtet e dritës/shikimit. Për shembull mjegulla nuk mund të dallohet nga sensorët e dritës. Prandaj në këtë kushte moti si dhe gjatë udhëtimit në errësirë ndizni gjithmonë dritat e zbehura .
– Në mënyrë që trafiku që vjen pas jush të mos verbohet, ju lejoheni ta ndizni dritën e pasme të mjegullës vetëm në përputhje me përcaktimet ligjore.

Udhëzim

– Gjatë parkimit të automjetit dhe në rastin e përdorimit të pajisjeve të ndriçimit kini parasysh rregulloret përkatëse specifike sipas vendit.
– Pas një shkarkimi për një kohë të gjatë të baterisë së automjetit, drita e qëndrimit ose e parkimit mund të fiket automatikisht. Mënjanoni përdorimin e dritës së parkimit për shumë orë. Nëse është e nevojshme ndizni dritën e djathtë ose të majtë të parkimit.
– Sensori i dritës për dritat automatike të udhëtimit* gjendet në këmbën fiksuese të pasqyrës së brendshme. Prandaj në këtë zonë mos ngjisni asnjë etiketë në xhamin e përparmë.
– Kur është ndezur drita e udhëtimit ditën* ndriçojnë vetëm fenerët e përparmë. Në disa modele të disa vendeve të caktuara ndizen edhe dritat e pasme.

▶

– Në kushte moti të ftohta ose me lagështirë fenerët, sinjalet dhe dritat e pasme për shkak të ndryshimit të temperaturës mund të vishen me ajër të kondensuar ndërmjet zonës së brendshme dhe të jashtme. Nëse e ndizni dritën e udhëtimit, ato pas një kohe të shkurtër lirohen përsëri plotësisht ose në pjesën më të madhe. Kjo dukuri nuk ka ndikim mbi jetëgjatësinë e pajisjes së ndriçimit.

Leva e sinjaleve dhe e dritave të gjata



Fig. 27 Leva e komandimit: Ndezja e sinjaleve dhe e dritave të gjata

Me këtë levë përveç sinjaleve komandohen edhe drita e gjata, dritat e parkimit dhe frexhat.

Sinjalet ⇦ ⇨ dhe drita e parkimit P

Nëse e lëvizni levën kur kuadri është i ndezur në pozicionin përkatës, atëherë ndizet sinjali. Drita përkatëse e kontrollit ⇦ ose ⇨ pulson. Nëse vetëm e prekni levën, sinjali ndizet tre herë (sinjali komod).

Kur kuadri është i fikur ndizet një dritë parkimi:

(1) Sinjali/Drita e parkimit djathtas

(2) Sinjali/Drita e parkimit majtas

Kur kuadri është i fikur, ndizni dritën e parkimit në të dyja anët, duke ndezur dritën e qëndrimit dhe duke e mbyllur nga jashtë automjetin.

Nëse një dritë kontrolli pulson dy herë më shpejt se normalisht, atëherë njëri nga sinjalet ka defekt. Udhëtoni menjëherë dhe me kujdes te një ndërmarrje e specializuar dhe riparojeni defektin.

Dritat e gjata dhe frexhat

▸ Lëvizeni levën në pozicionin e caktuar:

(3) Dritat e gjata të ndezura (Automjetet me asistent për dritat e gjata* ⇨ *faqja 40*)

(4) Dritat e gjata të fikura ose frexha

Në kruskot ndriçon drita e kontrollit.

VINI RE

Nëpërmjet dritave të gjata mund të verbohen shumë drejtuesit e tjerë të mjeteve – Rrezik aksidenti! Prandaj përdorini dritat e gjata ose frexhat vetëm nëse nuk verbohet askush.

Asistenti i dritave të gjata

Vlen për: Automjetet me asistent për dritat e gjata

Asistenti i dritave të gjata i ndez/fik dritat e gjata në varësi të ndikimeve të mjedisit.

Me anën e një kamere në këmbën fiksuese të pasqyrës së brendshme mund të regjistrohen burimet e dritës të përdoruesve të tjerë të rrugës. Në varësi të pozicionit të automjeteve që udhëtojnë para ose që ju vijnë përballë, shpejtësisë së automjetit si dhe kushteve të tjera të mjedisit dhe të trafikut, dritat e gjata ndizen/fiken automatikisht.

Tek automjetet me fenerët LED-Matrix* ndizen ose fiken segmentet individuale të dritave të gjata. Zona relevante para automjetit mbulohet, pjesa tjetër mbetet e hapur. Në këtë mënyrë mjedisi ndriçohet në mënyrë optimale, pa verbuar përdoruesit e rrugës.

Aktivizimi i asistentit të dritave të gjata AUTO

Kusht: Pozicioni i çelësit të ndriçimit AUTO është konfiguruar, dritat e shkurtra janë ndezur dhe asistenti i dritave të gjata është ndezur në sistemin e informimit dhe argëtimit ⇨ *faqja 41*.

▸ Për ta aktivizuar asistentin e dritave të gjata, shtyjeni levën para (3) ⇨ *faqja 40, fig. 27*. Drita e kontrollit AUTO shfaqet në ekranin e kruskotit dhe dritat e gjata ndizen/fiken automatikisht. Nëse dritat e gjata u ndezën pjesërisht ose plotësisht, ndriçon drita e kontrollit AUTO. ▸

Aktivizimi/çaktivizimi manual i dritave të gjata

Nëse dritat e gjata nuk u ndezën/fikën një herë siç pritej, ju mund t'i komandoni ato manualisht:

- ▸ Për t'i aktivizuar manualisht dritat e gjata, prekni levën para (3). Drita e kontrollit ndriçon.
- ▸ Për t'i çaktivizuar manualisht dritat e gjata, tërhiqeni levën mbrapa (4). Asistenti i dritave të gjata është i çaktivizuar.

Aktivizimi i frexhave

- ▸ Për të aktivizuar frexhat kur asistentët e dritave të gjata janë të aktivizuar dhe dritat e gjata të fikura, tërhiqeni levën mbrapa (4). Asistenti i dritave të gjata qëndron i aktivizuar.

VINI RE

Asistenti i dritave të gjata ka vetëm një funksion mbështetës. Përgjegjësia për kontrollin e dritës së udhëtimit dhe përshtatjes me kushtet e dritës/shikimit mbetet gjithmonë te drejtuesi i mjetit. Në situatat e mëposhtme mund të jetë e nevojshme një ndërhyrje manuale:

- – Në rastin kur kushtet e motit nuk janë të përshtatshme si mjegulla, reshje të mëdha, dëbora me vorbull ose stërkala.
- – Në rrugë, në të cilat qarkullimi në krah të kundërt mbulohet pjesërisht, p.sh. autostrada.
- – Në rastin e përdoruesve të tjerë të rrugës me ndriçim të keq si p.sh. çiklistët.
- – Në kthesa të ngushta, në malore të pjerrëta dhe gropa.
- – Në vende me ndriçim të keq.
- – Në rastin e reflektorëve të fortë, p.sh. tabelat.
- – Nëse xhami i përparmë në zonën e sensorit vishet me avull, ndotet, ngrin ose mbulohet nga etiketa e ngjitur.
- – Nëpërmjet dritave të gjata mund të verbohen shumë drejtuesit e tjerë të mjeteve – Rrezik aksidenti! Prandaj përdorini dritat e gjata ose frexhat vetëm nëse nuk verbohet askush.

Udhëzim

Kushtojini vëmendje gjatë përdorimit të pajisjeve të ndriçimit rregulloreve të vendeve përkatëse, p.sh. për sa i përket verbimit të përdoruesve të tjerë të rrugës. Përgjegjësia për respektimin e rregulloreve të vendeve përkatëse mbetet gjithmonë te drejtuesi i mjetit.

Konfigurimi i ndriçimit të jashtëm

Cilësimet e mëposhtme varen nga pajisja e automjetit.

Funksionet konfigurohen në sistemin e informimit dhe argëtimit.

- ▸ Zgjidhni në sistemin e informimit dhe argëtimit: Butoni MENU > **Car** (Automjeti) > butoni i majtë i komandimit > **Vehicles settings** (Cilësimet e automjetit)> **Outdoor lighting** (Ndriçimi i jashtëm).

Dritat automatike të udhëtimit

Në menynë **Automatic headlights** (Fenerët automatikë) keni mundësitë e mëposhtme të konfigurimit:

Activation time (Momenti i ndezjes) – Nëse drita automatike e udhëtimit ndizet **Early** (Herët), **Medium** (Mesatarisht) ose **Late** (Vonë), mund ta konfiguroni me ndjeshmërinë e sensorit të dritës.

Main beam assist (Asistenti i dritave të gjata) – Ju mund ta ndizni/fikni asistentin e dritave të gjata.

Entry/exit lights (Dritat e hyrjes/daljes)

Entry/exit light (Drita e hyrjes/daljes) siguron në rastin e errësirës që gjatë hapjes së automjetit dhe pas fikjes së kuadrit dhe hapjes së derës së drejtuesit të mjetit mjedisi rrethues i automjetit të ndriçohet.

Drita e hyrjes/daljes funksionon në errësirë dhe në pozicionin **AUTO** të çelësit të dritave.

Drita për qarkullimin majtas/qarkullimin djathtas

Nëse udhëtoni në një vend, në të cilin ndryshe nga vendi juaj udhëtohet në anën tjetër të rrugës, ▶

81B012790AG

duhet që fenerët të jenë konfiguruar saktë. Fenerët janë konceptuar për qarkullim në krahun e majtë si dhe në krahun e djathtë.

Përjashtim: Konfiguroni në rastin e udhëtimeve në autostrada në çelësin e dritave dritat e zbehta, për të mënjanuar verbimin e trafikut që ju vjen nga para.

Bllokazhi

Fig. 28 Kruskoti: Butoni për bllokazhin

Bllokazhi shërben në situata rreziku për t'i tërhequr vëmendjen përdoruesve të tjerë të rrugës për sa i përket automjetit tuaj.

▸ Për ta ndezur/fikur bllokazhin, shtypni butonin .

Kur bllokazhi është i ndezur pulsojnë në të njëjtën kohë dritat e kontrollit dhe .

Në rastin e një frenimi të plotë në shpejtësi të larta pulsojnë dritat e frenave, më pas ndizet bllokazhi [1].

Kur bllokazhi është i ndezur, mund të tregoni një ndryshim të drejtimit/të korsisë duke lëvizur levën e sinjaleve. Bllokazhi ndërpritet përkohësisht.

Bllokazhi funksionon edhe kur kuadri është i fikur.

Këshilla për drejtuesin e mjetit

Në varësi të pajisjes së automjetit mund të shfaqen udhëzimet e mëposhtme për drejtuesin e automjetit:

Nëse ndriçon drita e kontrollit , ka defekt një llambë. Këshilla për drejtuesin e mjetit jep pozicionin e llambës. Zëvendësoni menjëherë llambën.

Vehicle lighting: fault. Please contact workshop (Ndriçimi i automjetit: Defekt! Shkoni te një servis)

Kemi të bëjmë me një defekt të fenerit ose të çelësit të dritave. Udhëtoni më pas te një ndërmarrje e specializuar dhe riparojeni defektin.

Audi adaptive light: fault. See owner's manual (Audi adaptive light: Defekt! Shihni librin e bordit)

Adaptive light është jashtë funksioni. Dritat e zbehta vazhdojnë të funksionojnë.

Udhëtoni më pas te një ndërmarrje e specializuar dhe riparojeni defektin.

Automatic headlights: fault. See owner's manual (Dritat automatike të udhëtimit: Defekt! Shihni librin e bordit)

Sensori i dritës/shiut nuk funksionon.

Në pozicionin e çelësit të dritave **AUTO**, për arsye sigurie dritat e shkurtra ndizen gjatë gjithë kohës. Ju mund ta fikni/ndizni dritën më pas si më parë me çelësin e dritave.

Udhëtoni më pas te një ndërmarrje e specializuar dhe riparojeni defektin.

Headlight range control: fault. See owner's manual (Rregullimi i distancës së ndriçimit: Defekt! Shihni librin e bordit)

Kemi të bëjmë me një defekt në rregullimin e distancës së ndriçimit dinamik, për shkak të së cilit ju mund të verboni përdorues të tjerë të rrugës.

Shkoni menjëherë te një oficinë e specializuar dhe riparoni defektin.

Main beam assist: fault. See owner's manual (Asistenti i dritave të gjata: Defekt! Shihni librin e bordit) ▶

[1] Ky funksion nuk është i disponueshëm tek të gjitha modelet e vendeve.

Udhëtoni më pas te një ndërmarrje e specializuar dhe riparojeni defektin. Ju mund të vazhdoni t'i ndizni/fikni manualisht dritat e gjata si më parë.

Main beam assist: currently unavailable. Camera view restricted due to surroundings. See owner's manual (Asistenti i dritave të gjata: nuk ndodhen në dispozicion për momentin. Fushëpamja e kamerës është e kufizuar për shkak të mjedisit. Shihni librin e bordit)

Fushëpamja e kamerës është e prishur p.sh. nga etiketa e ngjitur ose ndotja. Pastroni xhamin e përparmë.

Sensori gjendet në këmbën e fiksuar të pasqyrës së brendshme. Prandaj në këtë zonë mos ngjisni asnjë etiketë në xhamin e përparmë.

Ndriçimi i brendshëm

Ndriçimi i brendshëm para

Fig. 29 Tavani panoramik: Ndriçimi i brendshëm para

Butonat për ndriçimin e brendshëm

* – Ndriçimi i brendshëm i ndezur/fikur

– Çelësi me kontakt i derës i ndezur/fikur. Ndriçimi i brendshëm komandohet automatikisht.

Dritat e leximit të ndjeshme kundrejt prekjes*

- ▸ Për ta ndezur fikur dritën përkatëse të leximit, prekni shkurtimisht sipërfaqen (1).
- ▸ Për ta aktivizuar funksionin manual të zbehjes, prekni për aq kohë sipërfaqen (1), derisa të arrihet shkalla e dëshiruar e ndriçimit.

Ndriçimi i brendshëm mbrapa

Vlen për: Automjetet me dritat e leximit mbrapa

Fig. 30 Tavani panoramik: Dritat e leximit mbrapa

- ▸ Për ta ndezur/fikur dritën përkatëse të leximit, shtypni butonin ose *.

Ndriçimi i ambientit

Vlen për: Automjetet me ndriçim ambienti

Ndriçimi i ambientit mund të konfigurohet në sistemin e informimit dhe argëtimit.

- ▸ Zgjidhni në sistemin e informimit dhe argëtimit: Butoni MENU > **Car** (Automjeti) > butoni i majtë i komandimit > **Vehicle settings** (Cilësimet e automjetit) > **Background lighting** (Ndriçimi i ambientit).

Në varësi të pajisjes së automjetit mund të konfigurohet ndriçimi i zonave individuale:

- ▸ Shtypni butonin e djathtë të komandimit dhe zgjidhni një nga zonat e treguara.

Ndriçimi i ambientit ndriçon nëse ndizni dritat e shkurtra kur kuadri është i ndezur.

Ndriçimi i instrumenteve

Fig. 31 Çelësi i dritave: Ndriçimi i instrumenteve ▸

– Drita bazë e ndriçimit të instrumenteve dhe të ekranit mund të konfigurohet.

- Për ta zhbllokuar butonin, prekeni atë.
- Për ta reduktuar/rritur dritën, rrotulloheni butonin në drejtimin -/+.
- Për ta fiksuar butonin, prekeni atë përsëri.

Udhëzim

Në varësi të modelit të automjetit kur drita është e fikur dhe kuadri i ndezur ndizet ndriçimi i instrumenteve (treguesit dhe shkallët). Me rënien e ndriçimit të mjedisit, ndriçimi i shkallëve reduktohet në mënyrë automatike dhe fiket eventualisht plotësisht. Ky funksion duhet ta kujtojë drejtuesin e mjetit, që të ndezë në kohën e duhur dritën e zbehur.

Pamja

Rregullimi i pasqyrës së jashtme

Fig. 32 Dera e drejtuesit të mjetit: Butoni i rrotullueshëm për pasqyrat e jashtme

- Rrotullojeni butonin e rrotullueshëm në derën e drejtuesit të mjetit në pozicionin përkatës:

0 – Të gjithë funksionet e konfigurimit janë çaktivizuar.

/ – Zgjidhni pasqyrën e jashtme majtas/djathtas. Për të konfiguruar sipërfaqen përkatës të pasqyrës, anojeni butonin e rrotullueshëm në drejtimin e dëshiruar.

– Ngrohja e sipërfaqeve të pasqyrave në varësi të temperaturës së jashtme*.

– Palosja e pasqyrave të jashtme*. Për t'i hapur pasqyrat, rrotulloheni butonin e rrotullueshëm në një nga pozicionet e tjera. Në sistemin e informimit dhe argëtimit ju mund të ndizni/fikni në mënyrë që pasqyrat të palosen automatikisht kur mbyllet automjeti ⇨ *faqja 26*.

Funksioni i animit* të pasqyrës së jashtme të pasagjerit para

Kusht: Butoni i rrotullueshëm qëndron në pozicionin për pasqyrën e jashtme të pasagjerit para.

Sipërfaqja e pasqyrës anohet lehtë kur futet marshi i lëvizjes mbrapa, për të pasur p.sh. kur parkoni duke lëvizur mbrapa një fushëpamje më të mirë të cepave të trotuarit.

Mund ta konfiguroni sipërfaqen e pasqyrës duke e anuar butonin e rrotullueshëm në drejtimin e dëshiruar. Gjatë nxjerrjes së marshit të lëvizjes mbrapa ruhet një pozicion i ri dhe i caktohet çelësit të përdorimit me valë.

Pasqyra kthehet përsëri në pozicionin fillestar, sapo të ecni përpara më shpjet se 15 km/h ose nëse fikni kuadrin.

VINI RE

Sipërfaqet e lakuara të pasqyrave (konveks ose asferike*) zmadhojnë fushëpamjen. Por ato i bëjnë objektet që në pasqyrë të duken më të vegjël dhe më larg. Nëse përdorni këto pasqyra për të përcaktuar distancën me automjetin që keni mbrapa gjatë ndryshimit të korsisë, mund të gaboni – Rrezik aksidenti!

KUJDES

– Vlen për: Automjete me pasqyra të jashtme të palosshme elektrikisht: Nëse kasa e pasqyrës u lëviz për shkak të ushtrimit të forcave nga jashtë (p.sh. u godit gjatë kryerjes së manovrave), duhet t'i mbyllni në mënyrë elektrike deri në fund pasqyrat. Nëse pasqyrat janë fiksuar përsëri në pozicionin e tyre, kjo gjë dallohet për shkak të një zhurme të lartë. Kasa e pasqyrave nuk lejohet kurrë që të çohet me dorë në vendin e vet, pasi përndryshe dëmtohet funksioni i sistemit mekanik të pasqyrave.

– Vlen për: Automjete pa pasqyra të jashtme të palosshme elektrikisht: Nëse kasa e pasqyrës u lëviz për shkak të ushtrimit të ▶

forcave nga jashtë (p.sh. u godit gjatë kryerjes së manovrave), duhet ta ktheni përsëri me dorë në pozicionin e vet.
– Nëse e lani automjetin në një lavazh automatik, duhet t'i palosni pasqyrat e jashtme për të mënjanuar dëmtimin e pasqyrave të jashtme. Pasqyrat e jashtme të palosshme elektrikisht* nuk lejohen kurrë të palosen/hapen me dorë por vetëm elektrikisht!

Udhëzim

Nëse konfigurimi elektrik dështon, të dyja sipërfaqet e pasqyrave mund të rregullohen me dorë duke i shtypur në cepin e xhamit.

Verbimi i pasqyrave

Automjeti juaj është i pajisur me një pasqyrë të brendshme manuale ose automatike* që errësohet ngadalë.

Pasqyra e brendshme që verbohet manualisht

▸ Tërhiqeni poshtë levën në cepin e poshtëm të pasqyrës.

Pasqyrat që verbohet automatikisht*

▸ Pasqyrat e brendshme dhe të jashtme verbohen automatikisht kur mbi to bie dritë (p.sh. dritë fenerësh nga mbrapa).

VINI RE

Vlen për: Automjetet me pasqyra që verbohen automatikisht

Nga një xham i thyer i pasqyrës mund të rrjedhë substancë e lëngshme elektroliti. Kjo substancë e lëngshme mund të irritojë lëkurën, sytë dhe organet e frymëmarrjes. Në rast kontakti me këtë substancë të lëngshme lajeni menjëherë me shumë ujë. Nëse është e nevojshme shkoni te një mjek.

KUJDES

Vlen për: Automjetet me pasqyra që verbohen automatikisht

Nga një xham i thyer i pasqyrës mund të rrjedhë substancë e lëngshme elektroliti. Kjo substancë e lëngshme sulmon sipërfaqet plastike. Hiqeni substancën e lëngshme sa më shpejt të jetë e mundur me një sfungjer të lagur.

Udhëzim

Vlen për: Automjetet me pasqyra që verbohen automatikisht

– Nëse përkeqësohet rënia e dritës mbi pasqyrën e brendshme, pasqyrat që verbohet automatikisht nuk funksionojnë pa defekt.
– Në rastin kur është ndezur ndriçimi i brendshëm ose kur është vendosur marshi i lëvizjes mbrapa, pasqyrat që verbohet automatikisht nuk verbohen.

Pengueset e diellit

Fig. 33 Tavani panoramik: Penguesja e diellit

Penguesja e diellit mund të tërhiqet nga pikat ku ajo është fiksuar dhe mund të rrotullohet drejt derës (1).

Gjatë hapjes së kapakut të pasqyrës së Make-up (2) ndizet ndriçimi i pasqyrës*.

Fshirëset e xhamave

Ndezja e fshirëses së xhamave



Fig. 34 Leva e komandimit: Fshirëset e xhamave

Fig. 35 Leva e komandimit: Fshirësja e xhamit mbrapa

▸ Lëvizeni levën e fshirëses së xhamave në pozicionin përkatës:

(0) Fshirësja e xhamit e fikur

(1) Regjimi me intervale. Për të zgjatur/shkurtuar pauzat e fshirjes, lëvizeni çelësin (A) majtas/djathtas. Tek automjetet me sensorin e shiut* fshirëset e xhamave aktivizohen kur bie shi pas tejkalimit një herë të vetme me rreth 4 km/h. Sa më e lartë të konfigurohet ndjeshmëria e sensorit të shiut (çelësi (A) nga e djathta), aq më herët reagojnë fshirëset e xhamave kundrejt lagështirës në xhamin e përparmë. Ju mund ta çaktivizoni regjimin e sensorit të shiut në sistemin e informimit dhe argëtimit dhe të ndizni në këtë mënyrë regjimin me intervale.

▸ Zgjidhni në sistemin e informimit dhe argëtimit: Butoni MENU > **Car** (Automjeti) > butoni i majtë i komandimit > **Driver assist** (Asistenca e drejtuesit të mjetit) > **Rain sensor** (Sensori i shiut).

(2) Fshirja e ngadaltë

(3) Fshirja e shpejtë

(4) Fshirja një herë. Nëse e mbani levën për një kohë më të gjatë në këtë pozicion, pas një kohë të caktuar kalon nga fshirja e vazhdueshme e ngadaltë në fshirjen e vazhdueshme të shpejtë.

(5) Pastrimi i xhamit të përparmë. Për të mënjanuar rrëketë e ujit, fshirësja e xhamave fshin gjatë udhëtimit kur temperaturat janë mbi rreth 4 °C edhe njëherë pas disa sekondash. Ju mund ta fikni këtë funksion, duke e lëvizur edhe njëherë levën brenda dhjetë sekondave pas fshirjes së fundit në pozicionin (5). Herën tjetër që ndizet kuadri funksionin i pas-fshirjes është përsëri aktiv.

Impianti i pastrimit të fenerëve* funksionon vetëm kur janë ndezur dritat e zbehta. Nëse e lëvizni levën në pozicionin (5), fenerët pastrohen në intervale të caktuara.

(6) Fshirja e xhamit të pasmë. Fshirësja e xhamit të pasmë lëviz disi çdo gjashtë sekonda.

Sapo të vendoset marshi i lëvizjes mbrapa dhe në të njëjtën kohë është ndezur fshirësja e përparme dhe është në punë, ndizet automatikisht edhe fshirësja e pasme.

(7) Pastrimi i xhamit të pasmë. Numri i proceseve të fshirjes varet nga fakti, se për sa kohë e mbani ju levën në pozicionin (7).

VINI RE

– Sensori i shiut* ka vetëm një funksion të asistencës. Ai nuk ja heq drejtuesit të mjetit përgjegjësinë e tij për të ndezur fshirëset e xhamave në mënyrë manuale në përputhje me kushtet e shikimit.
– Xhami i përparmë nuk lejohet që të trajtohet me agjentë për veshjen e xhamave që nuk përshkohen nga uji. Në kushte jo të përshtatshme të shikimit si p.sh. në lagështirë, errësirë ose kur dielli qëndron poshtë mund të shkaktohet një verbim i fortë – Rrezik aksidenti! Përveç të tjerave mund të ndodhë edhe rrëshqitja e fletëve të fshirëseve të xhamave.
– Fletët e padëmtuara të fshirëseve të xhamave janë të domosdoshme me patjetër për një shikim të qartë dhe një udhëtim të ▸

sigurt ⇨ *faqja 47, Ndërrimi i fshirëses së xhamave përpara* – Rrezik aksidenti!

KUJDES

– Kontrolloni në rastin e ngricave nëse fletët e fshirëseve të xhamave kanë ngrirë. Nëse i ndizni fshirëset e ngrira të xhamave, fletët e fshirëseve mund të dëmtohen!
– Para se të përdorni një lavazh me automjetin tuaj, duhet që ta fikni impiantin e fshirëseve së xhamave (Leva në pozicionin 0). Në këtë mënyrë parandalohet ndezja pa dashje dhe në këtë mënyrë dëmtimet e impiantit të fshirëseve të xhamave.

Udhëzim

– Fshirëset e xhamave fiken kur fikjet kuadri. Ju i aktivizoni fshirëset e xhamave pas rindezjes së kuadrit, duke e çuar levën e fshirëses së xhamave në një pozicion sipas dëshirës.
– Fletët e fshirëseve të xhamave të konsumuara ose të ndotura shkaktojnë formimin e vijave. Në këtë mënyrë mund të përkeqësohet funksionimi i sensorit të shiut. Kontrolloni rregullisht fletët e fshirëseve tuaja të xhamave.
– Sprucatorët e larjes së impiantit të fshirëseve të xhamave ngrohen* kur kuadri është i ndezur dhe në temperatura të ulëta.
– Gjatë qëndrimit të përkohshëm, p.sh. ndalimit në semafor, shpejtësia e konfiguruar e fshirëses së xhamave ulet në mënyrë automatike me një shkallë.

Pastrimi i fletëve të fshirëses së xhamave

Pastroni fletët e fshirëses nëse fshirësja e xhamave formon vija. Për këtë përdorni një pecetë të butë dhe një pastrues për xhama.

Fshirësja e xhamave përpara

- Vendoseni krahun e fshirëses së xhamave në pozicionin e servisit ⇨ *faqja 47*.
- Largoheni krahun e fshirëses së xhamave nga xhami i përparmë.

Fshirësja e xhamit të pasmë

- Largojeni krahun e fshirëses nga xhami i pasmë.

VINI RE

Fletët e ndotura të fshirëseve të xhamave mund të përkeqësojnë shikimin – Rrezik aksidenti!

KUJDES

Nëse fshirësja e xhamave vazhdon të formojë vija pas pastrimit, ato duhen ndërruar ⇨ *faqja 47*.

Ndërrimi i fshirëses së xhamave përpara



Fig. 36 Fshirësja e xhamave përpara: Heqja e fletëve të fshirëses

Pozicioni i servisit/pozicioni i ndërrimit të fshirëses

- Për t'i çuar fshirëset e xhamave në pozicionin e servisit, fikeni kuadrin dhe lëvizeni levën e fshirëses së xhamave për të paktën dy sekonda në pozicionin 4 ⇨ *faqja 46, fig. 34*.
- Për t'i çuar fshirëset e xhamave përsëri në pozicionin fillestar, ndizeni kuadrin dhe mbajeni levën e fshirëseve të xhamave në pozicionin 4, derisa fshirëset e xhamave të kthehen në pozicionin fillestar ose udhëtoni më shpejt se 12 km/h.

Heqja e fletës së fshirëses

- Largojeni krahun e fshirëses nga xhami i përparmë.
- Shtypni te fleta e fshirëses butonin fiksues 1 ⇨ *fig. 36*. Mbajeni me dorë fletën e fshirëses.
- Hiqni fletën e fshirëses në drejtimin e shigjetës. ▶

81B012790AG

Montimi i fshirëses së xhamit

- Vendoseni fletën e re të fshirëses në folenë e krahut të fshirëses së xhamave (2), derisa të dëgjohet që u fiksua.
- Kthejeni mbrapa krahun e fshirëses së xhamave mbi xhamin e përparmë.
- Fikni përsëri pozicionin e servisit.

VINI RE

Për arsye sigurie duhet që fletët e fshirëseve të xhamave të ndërrohet një deri në dy herë në vit.

KUJDES

– Hapni fshirësen e xhamave vetëm në pozicionin e servisit! Përndryshe ekziston rreziku i dëmtimit të bojës së kofanos ose i dëmtimit të motorit të fshirëseve të xhamave.
– Nëse krahët e fshirëseve të xhamave janë hapur, nuk lejoheni ta drejtoni automjetin ose të prekni levën e fshirëseve të xhamave. Përndryshe fshirëset e xhamave kthehen automatikisht në pozicionin e tyre fillestar dhe mund të dëmtojnë në këtë mënyrë kofanon dhe xhamin e përparmë!

Udhëzim

– Pozicionin e servisit ju mund ta përdorni për shembull edhe nëse ju në dimër dëshironi ta mbroni xhamin e përparmë me një mbulesë kundrejt ngrirjes.
– Kur kofano është e hapur ju nuk mund ta aktivizoni pozicionin e servisit.

Ndërrimi i fshirëses së xhamave mbrapa

Fig. 37 Fshirësja e xhamave mbrapa: Heqja e fletës së fshirëses

Heqja e fletës së fshirëses

- Largojeni krahun e fshirëses nga xhami i pasmë.
- Tërhiqeni fletën e fshirëses poshtë mesit në drejtimin e shigjetës nga mekanizmi mbajtës. Mbajeni me dorë krahun e fshirëses së xhamave.

Montimi i fshirëses së xhamit

- Shtypeni folenë e fletë së fshirëses në mekanizmin mbajtës. Mbajeni me dorë krahun e fshirëses në fundin e sipërm plastik.
- Kthejeni krahun e fshirëses mbrapa mbi xhamin e pasmë.

VINI RE

Për arsye sigurie duhet që fletët e fshirëseve të xhamave të ndërrohet një deri në dy herë në vit.

Këshilla për drejtuesin e mjetit

Në varësi të pajisjes së automjetit mund të shfaqen udhëzimet e mëposhtme për drejtuesin e automjetit:

Nëse ndriçon drita e kontrollit, kemi të bëjmë me një defekt te fshirësja e xhamit. Shkoni menjëherë te një ofiçinë e specializuar dhe riparoni defektin.

Automatic wipers: fault. See owner's manual (Fshirëset automatike: Defekt! Shihni librin e bordit)

Sensori i dritës/shiut nuk funksionon. ▶

Ashtu si edhe më parë, mund të përdorni të gjitha funksionet e levës së fshirëseve të xhamave, të cilat janë të pavarur nga sensori i shiut.

Udhëtoni më pas te një ndërmarrje e specializuar dhe riparojeni defektin.

81B012790AG



Audi Vorsprung durch Technik